



BASHKITË PËR NË EVROPË
Një projekt i financuar nga BE

BASHKITË NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Raporti i parë 2018





BASHKITË NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË **BASHKIMIN EVROPIAN**

Raporti i parë 2018

SHENIM

- Ky është Raporti i Parë që sjell në vëmendje rëndësinë e pushtetit vendor në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian në lidhje me përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit dhe përmbushjes së detyrimeve duke filluar nga viti 2017.

- Raporti u hartua me kontributin e **Znj. Zana Vokopola** dhe **Znj. Entela Kallamata**, eksperte në fushën e pushtetit vendor dhe decentralizimit pranë Institutit të Kërkimeve Urbane, Tiranë.

- Raporti u hartua në kuadrin e Projektit “**Bashkitë për në Evropë**”, nën kujdesin e **Znj. Jolanda Trebicka**, Drejtuese e Projektit.

- *Procesi i mbledhjes së të dhënave u krye në periudhën nëntor 2017 - janar 2018 dhe u asistua me profesionalizem nga Agjensia në Mbështetje të Vetë-Qeverisjes Vendore si dhe Ministria e Brendshme. Po ashtu, Koordinatorët Lokalë të Këndeve të BE-se në secilën Bashki kontribuan në koordinimin dhe procesin e mbledhjes së të dhënave në secilën bashki.*

- **Ky Raport është realizuar me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë. Përmbajtja e tij mbetet përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e**

TABELA E PERMBLEDHJES

PERMBLEDHJE	8
I. HYRJE	16
II. METODOLOGJIA	17
III. KRITERI POLITIK	18
1. Demokracia	18
1.1 Qeverisja	18
1.2 Avokati i Popullit	23
1.3 Shoqëria civile	23
<i>Përfundime mbi demokracinë</i>	24
2. Zbatimi i ligjit	25
2.1 Lufta kundër korrupsionit	25
<i>Përfundime mbi zbatimin e ligjit</i>	28
3. Të drejtat e njeriut	29
<i>Përfundime mbi të drejtat e njeriut</i>	30
IV. KRITERI EKONOMIK	31
1. Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale	31
<i>Përfundime mbi ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale</i>	34
V. AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSISË	35
1. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural	35
<i>Përfundime mbi bujqësinë dhe zhvillimin rural</i>	38
2. Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare	39
<i>Përfundime mbi politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare</i>	41
3. Kapitulli 14: Politika e transportit	42
<i>Përfundime mbi politikën e transportit</i>	43
4. Kapitulli 15: Energjia	44
<i>Përfundime mbi energjinë</i>	47
5. Kapitulli 16: Tatimet	48
<i>Përfundime mbi tatimet</i>	50
6. Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi	51
<i>Përfundime mbi politikën sociale dhe punësimin</i>	56
7. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore	57
<i>Përfundime mbi gjyqësorin dhe të drejtat themelore</i>	71
8. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria	73
<i>Përfundime mbi drejtësinë, lirinë dhe sigurinë</i>	74
9. Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura	75
<i>Përfundime mbi arsimin dhe kulturën</i>	80
10. Kapitulli 27: Mjedi dhe ndryshimi i klimës	81
<i>Përfundime mbi mjedisin dhe ndryshimin e klimës</i>	87
11. Kapitulli 32: Kontrolli Financiar	88
<i>Përfundime mbi kontrollin financiar</i>	89
LISTA E GRAFIKEVE	90

SHKURTIME

BE	Bashkimi Evropian
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPPS	Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016-2020
DSNM	Draft Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015-2020
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
LKKO	Lufta Kundër Krimit të Organizuar
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKPPAK	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2011-2018
PKVIRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020
PRESH	Programi i Reformave Ekonomike të Shqipërisë 2017-2019
SHAP	Shkolla e Administratës Publike
SKBGJPV	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020
SKMS	Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020
SNDQV	Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020
SNRAP	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020
SZHAP	Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020



Bashkimi Evropian është plotësisht i vendosur të mbështesë Shqipërinë në rrugën drejt anëtarësimit në BE. Anëtarësimi bëhet realitet nëpërmjet kontributit të të gjitha niveleve të qeverisjes dhe të gjithë shoqërisë. Kur administrata vendore dhe qytetarët përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë, mund të mësojnë më mirë, të përqafojnë mundësitë dhe të përballen në mënyrë me efektive me sfidat që mbart integrimi në BE.

Ngritja e një Këndi të BE-së/EU Desk në çdo bashki kushtuar Bashkimit Evropian është një nismë e përbashkët me autoritetet shqiptare. Këndet e BE-së janë ngritur tashmë dhe janë funksionale. Ato kontribuojnë në shpërndarjen e informacionit dhe angazhimin e administratës vendore dhe qytetarëve në çështjet që kanë lidhje me BE-në: politikat e saj, fondet dhe programet. Gjithashtu, ato janë mjaft thelbësore në matjen e kontributit të bashkive në përputhje me axhendën që ka vendi në lidhje me BE-në.

Integrimi në Bashkimin Evropian përbën një sfidë më vete. Me progresin në hapat drejt aderimit, drejtuesit e qeverisjes lokale dhe administratat e tyre do të përballen edhe me më shumë kërkesa të tjera që duhen plotësuar. Ata duhet të sigurojnë që qytetarëve të tyre t'u ofrohen të njëjtat shërbime, ashtu si edhe qytetarëve të Bashkimit Evropian dhe që demokracia lokale të zbatohet në mënyrë eficiente dhe gjithëpërfshirëse. Zhvillimi i politikave dhe programeve të reja duhet të bazohet në të dhëna të vërtetueshme, të mbështetura plotësisht në informacione të qarta dhe të sakta sa u përket zbatimit të standardeve dhe kriterëve të BE-së në nivel vendor.

Ky Raport i performancës së Bashkive në lidhje me çështjet e BE-së është ushtrimi i parë i këtij lloji. Ai bën një fotografim të shpejtë të situatës lidhur me statusin e përmbyshjes së përgjegjësive të bashkive shqiptare që qartazi lidhen me procesin e anëtarësimit të vendit. Bashkitë japin një kontribut shumë të rëndësishëm ndër të tjera edhe në fushën e sundimit të së drejtës, të drejtave të njeriut, politikave sociale, bujqësisë dhe zhvillimit rural, arsimit dhe mjedisit. Tani që Shqipëria po zhvillon një arkitekturë institucionale kushtuar posaçërisht integritit në BE në nivel vendor, ky ushtrim do të shërbejë si një pikë e rregullt referimi për monitorim të mëtejshëm të procesit të integritit në BE në nivel vendor.

Së bashku me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrinë e Brendshme, ne besojmë se bashkitë shqiptare që do të kontribuojnë si një motor i fuqishëm në rrugën e vendit drejt Bashkimit Evropian.

SH.S.Zj. Romana Vlahutin
Ambasadore e BE-së në Shqipëri

PERMBLEDHJE

Qëllimi i këtij raporti është të sjellë në vëmendje rëndësinë e qeverisë vendore në procesin e integritit të Shqipërisë në BE duke paraqitur përgjegjësinë e saj në drejtim të përmbushjes së kritereve të anëtarësimit dhe gjendjen e përmbushjes së tyre në vitin 2017, e cila të mund të jetë bazë për vlerësimin e performancës së qeverisë vendore në procesin e integritit në vitet në vazhdim. Raporti është ngritur sipas Planit Kombëtar për Integritimin Evropian 2017-2020 dhe Raportit të Komisionit Evropian mbi Shqipërinë 2016, gjithashtu, sipas dokumenteve strategjike e politike kombëtare dhe bazës ligjore të çdo fushe të kritereve të anëtarësimit në BE në të cilat qeveria vendore ka përgjegjësi, brenda kuadrit të funksioneve të vetëqeverisjes vendore përcaktuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Përfundimet e raportit përmbledhen në vijim.

KRITERI POLITIK

Demokracia

Zhvillimi i kapaciteteve të qeverisë vendore

Gjatë vitit 2017, administrata vendore është trajnuar më shumë për tema profesionale, me mesatarisht 7 trajnime dhe 14 nëpunës të trajnuar; në 29% të bashkive të vendit administrata nuk është trajnuar ende mbi legjislacionin për nëpunësin civil, ndërsa në 81% të tyre nuk është trajnuar mbi Kodin e Ri të Procedurave Administrative. Ndërkohë, 50% e bashkive nuk shpërndajnë buxhet për nëpunësit e administratës për pjesëmarrje në trajnime.

Zyrat me një ndalesë janë ngritur në 19 bashki, të cilat përbëjnë 31% të bashkive të vendit; në 37 bashki nuk janë ngritur ende, të cilat përbëjnë 61% të bashkive. Asnjë shërbim digjital nuk ofrohet ende në 52% të bashkive.

Rritja e llogaridhënies së qeverisë vendore

Gatë vitit 2017, qytetarët kanë marrë përgjigje për kërkesat dhe ankesat e tyre pranë bashkisë në mesatarisht 75% të rasteve; megjithatë dhënia e përgjigjeve zyrtare nuk përfaqëson domosdoshmërisht adresimin e plotë të kërkesës dhe ankesës së qytetarëve dhe nuk përfaqëson as zgjidhjen e problemit që ato përmbajnë.

Mungojnë ende sistemet e menaxhimit të performancës së qeverisë vendore. Strukturat komunitare nuk janë ngritur në thuajse asnjë bashki.

Rritja e transparencës së qeverisë vendore

Gjatë vitit 2017, të gjitha vendimet bashkiake ose ato më të rëndësishme, janë publikuar në faqen e internetit të bashkisë në 79% të bashkive të vendit. Numri mesatar i dëgjësive publike të zhvilluara gjatë procesit të hartimit të programit buxhetor afatmesëm është 5, dhe mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara është 6; nga ana tjetër, 14% e bashkive nuk kanë organizuar dëgjësia publike. Ende asnjë bashki në vend nuk përgatit një buxhet për qytetarët.

Përfshirja e komunitetit në vendimmarrjen e qeverisë vendore

Gjatë vitit 2017, në dëgjësat publike për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm – një nga proceset kryesore të vendimmarrjes vendore, kanë marrë pjesë mesatarisht 23 qytetarë; për nivelin e pjesëmarrjes së grupeve në nevojë, nëpërmjet organizatave të shoqërisë civile, nuk ka të dhëna të mjaftueshme. Dëgjësat publike dhe forumet e diskutimit me grupet shoqërore brenda komunitetit përbëjnë dy format kryesore të përdorura nga bashkitë për përfshirjen e komunitetit në këtë proces.

Përmirësimi i shqyrtimit nga bashkia të raporteve të konstatimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit

Gjatë vitit 2017, mesatarisht vetëm 1 raport ka qëndruar në proces shqyrtimi përtej afatit kohor të përcaktuar me ligj; nga ana tjetër, 41% e bashkive nuk kanë marrë asnjë raport nga Avokati i Popullit.

Konsolidimi i shoqërisë civile në nivel vendor

Për vitin 2017, afërsisht gjysma e bashkive të vendit nuk ka të dhëna për numrin e rekomandimeve të marra nga organizatat e shoqërisë civile gjatë procesit të vendimmarrjes së tyre vendore, dhe për numrin e rekomandimeve të pranuar.

Zbatimi i ligjit

Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe konfliktit të interesave

Gjatë vitit 2017, në kuadër të luftës kundër korrupsionit, në 87% të bashkive të vendit kryetarët kanë deklaruar pasurinë dhe interesat private.

Forcimi i kapaciteteve të qeverisë vendore në luftën kundër korrupsionit

Deri në vitin 2017, rrjeti i koordinatoreve vendorë anti-korrupsion është i ngritur në 36% të bashkive të vendit, ndërsa pikat e kontaktit vendor anti-korrupsion janë vendosur në 26% të tyre. Bashkitë kanë marrë pjesë në mesatarisht 1 trajnim të organizuar nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit.

Të drejtat e njeriut

Forcimi i kapaciteteve të qeverisë vendore për të zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Gjatë vitit 2017, bashkitë kanë marrë pjesë mesatarisht në 1 trajnim organizuar nga pushteti qendror apo shoqëria civile, me 4 nënpunës të trajnuar. 49% e bashkive kanë bashkëpunim të mirë me organizatat e shoqërisë civile për identifikimin dhe adresimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut, ndërsa 28% e tyre nuk kanë bashkëpunim në këtë fushë.

KRITERI EKONOMIK

Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Përmirësimi i mjedisit të biznesit

Deri në vitin 2017, 79% e bashkive të vendit nuk kanë ndërmarrë asnjë aktivitet për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e tyre si dhe nuk kanë ofruar asnjë shërbim mbështetës; 96% e bashkive nuk kanë shpërndarë buxhet të posaçëm për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Zyrat për zhvillimin dhe promovimin e turizmit janë ngritur dhe janë funksionale në 35 bashki, të cilat përbëjnë 57% të bashkive të vendit, ndërsa nuk janë ngritur ende në 38% të tyre.

AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSISË

Bujqësia dhe zhvillimin rural

Forcimi i kapaciteteve të qeverisë vendore në sistemin e informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural

Deri në vitin 2017, zyrat e informacionit bujqësor dhe këshilluese janë ngritur në 62% të bashkive të vendit, ndërsa mungojnë ende në 34% të tyre.

Përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë

Deri në vitin 2017, 57% e bashkive të vendit nuk kanë një rrjet të plotë ose lehtësues të rrugëve për lidhjen e zonave bujqësore me qendrat tregtare të tyre dhe të bashkive fqinje, ndërsa 21% kanë një rrjet të pjesshëm ose pjesërisht lehtësues.

Që prej fillimit të zbatimit të Reformës Administrative dhe Territoriale, buxheti për ndërtimin e këtij rrjeti rrugor është rritur në 33% të bashkive, ndërsa për 49% të tyre nuk ka pasur buxhet të posaçëm për këtë qëllim.

Rivendosja, ruajtja dhe zhvillimi i ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe pyjet

Deri në vitin 2017, vetëm 10% e bashkive të vendit kanë ose janë në hartim e sipër të një plani vendor për natyrën dhe biodiversitetin në territorin e tyre; këto janë kryesisht plane për ruajtjen dhe zhvillimin e ekosistemeve brenda territorit të bashkive me qëllim mbrojtjen e mjedisit, si lumenj ose pyje, por jo për ekosisteme të varura nga bujqësia.

Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare

Përmirësimi i kushteve sanitaro-veterinare me qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve

Deri në vitin 2017, bashkitë kanë në strukturën e tyre mesatarisht 3 inspektorë veterinerë. 54% e bashkive të vendit nuk janë trajnuar mbi kërkesat e BE-së në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë. Kontrollat veterinarë ushtrohen çdo ditë dhe pothuajse çdo ditë në 71% të bashkive; ato kanë raportuar mesatarisht 4 raste të shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore dhe veterinarë tek autoritetet qendrore; 51% të bashkive nuk kanë raportuar asnjë rast.

Politika e transportit

Rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor

Deri në vitin 2017, mesatarisht 61% e territorit të bashkive të vendit ka një rrjet rrugor ekzistues. Mesatarisht 36% e tij është brenda standardeve ligjore të ndërtimit dhe 27% e tij është brenda standardeve ligjore të sinjalistikës. 13% të bashkive nuk kanë shpërndarë buxhet të posaçëm për këtë qëllim.

Energjia

Rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë

Në vitin 2017, nga 71% deri 75% e bashkive të vendit nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim mbi kërkesat minimale ligjore për cilësi termike të ndërtesave me një banesë dhe shumë banesa, si dhe për shërbime private, përkatësisht. Asnjë nga bashkitë nuk ka punësuar punonjës shtesë për të kontrolluar kërkesat e eficiencës së energjisë në ndërtesa brenda territorit të saj. 91% e tyre nuk kanë kryer kontrole për ndërtesat me një dhe shumë banesa dhe për shërbime private.

Zbatimi i metodave për përmirësimin e eficiencës së energjisë

Në vitin 2017, në 83% të bashkive të vendit shërbime këshillimi për energjinë nuk janë ofruar dhe as nuk ka pasur bashkëpunim me autoritetet qendrore në këtë drejtim.

Tatimet

Përmirësimi i administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore përmes rritjes së bazës së tatueshme

Gjatë vitit 2017, 51% e bashkive të vendit kanë planifikuar ose zbatuar politika tatimore për nxitjen e formalizimit të ekonomisë në territorin e tyre. Bashkitë kanë ndërmarrë mesatarisht 271 inspektime në terren me qëllim parandalimin e ekonomisë jo formale. Ato kanë organizuar mesatarisht 4 dëgjesa publike për informimin dhe përfshirjen e biznesit në diskutimin e politikave tatimore të bashkisë; megjithatë, 11% të bashkive të vendit nuk kanë zhvilluar asnjë dëgjese. Baza e të dhënave të debitorëve është e ngritur në 89% të bashkive të vendit; një bazë e tillë mungon ende në 5 bashki të vendit.

Politika sociale dhe punësimi

Mbrojtja sociale në nivel vendor

Deri në vitin 2017, sektori për vlerësimin e nevojave dhe referimin për shërbime të kujdesit social është ngritur në 26% të bashkive të vendit; në 69% të tyre nuk është ngritur ende, pra nuk kryhet ende një vlerësim i nevojave të grupeve shoqërore për mbrojtje sociale.

Në 47% të bashkive nuk ka asnjë nëpunës të shtuar për sektorin e mbrojtjes sociale, dhe në 43% të bashkive nuk ka asnjë nëpunës të shtuar për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës kombëtare të ndihmës ekonomike. Në 84% të bashkive nuk është hartuar asnjë raport i performancës së shërbimeve të kujdesit social për PAK.

Në 48% të bashkive nuk ka një qendër ditore të kujdesit social; në 15% të tyre ka një qendër ditore për grupin PAK, ndërsa në 21% të bashkive janë të ngritura qendra multifunksionale të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit social për disa grupe në nevojë. Numri mesatar i personave që përfitojnë shërbim në qendrat e kujdesit social, ditore apo multifunksionale, është 154.

Mbështetja për programet aktive të punës

Në vitin 2017, 10% e bashkive të vendit kanë bashkëpunuar me drejtoritë arsimore rajonale për përmirësimin ose zgjerimin e mundësive për arsim profesional në territorin e tyre, sipas nevojave të tregut të punës. Megjithatë, 78% e bashkive nuk ofrojnë mbështetje financiare për arsimimin profesional të të papunëve në territorin e tyre që marrin ndihmë ekonomike, në bashkëpunim me zyrën rajonale të punësimit; në të njëjtën mënyrë, 80% e tyre nuk ofrojnë mbështetje financiare për personat nga grupi PAK. Gjithashtu, 81% e bashkive nuk ofrojnë mbështetje financiare për të rinjtë që përfundojnë arsimin universitar dhe profesional dhe duan të fillojnë një biznesi privat në fushën e tyre profesionale.

Përfshirja sociale në nivel vendor

Deri në vitin 2017, 10% e bashkive të vendit kanë një plan vendor veprimi për përfshirjen sociale. Gjithashtu, baza e të dhënave statistikore me treguesit e BE-së për përfshirjen sociale është e ngritur në 10% të bashkive të vendit; nga ana tjetër, 49% e bashkive nuk janë trajnuar nga ministria e linjës për metodologjinë e matjes dhe vlerësimit e monitorimit të treguesve kombëtarë dhe të BE-së për përfshirjen sociale.

Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Forcimi i sistemit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Deri në vitin 2017, 61% e bashkive të vendit kanë krijuar njësinë e mbrojtjes së fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore; njësia ende mungon në 34% të tyre; 49% e bashkive kanë krijuar gjithashtu një sistem monitorimi të rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje; në 44% e bashkive sistemi ende mungon.

Gjatë vitit 2017, në territorin e bashkive janë identifikuar mesatarisht 19 raste të shkeljes së të drejtave të fëmijës dhe numri mesatar i urdhrave të mbrojtjes të lëshuar është 17; nga ana tjetër, 82% e bashkive nuk kanë shpërndarë buxhet të posaçëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Mbrojtja nga diskriminimi

Deri në vitin 2017, në 25% të bashkive të vendit është krijuar një sistem për monitorimin e rasteve të diskriminimit të ndodhura në territorin e bashkisë, ndërsa në 69% të tyre ende nuk ka një sistem të tillë. Pjesa më e madhe e bashkive, 54%, nuk kanë bashkëpunim me komisionerin për mbrojtjen nga diskriminimi; 13% e tyre kanë lidhur një marrëveshje bashkëpunimi, gjithsesi nuk ndërmerren aktivitete të përbashkëta në këtë fushë, nuk ofrohen shërbime të përbashkëta, dhe as nuk ka një raportim të rregullt e të ndërsjellët mes dy institucioneve.

Mbrojtja e pakicave kombëtare

Deri në vitin 2017, në 28% të bashkive të vendit është krijuar një sistem për monitorimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të pakicave kombëtare në territorin e tyre; pakicat kombëtare që janë objekt monitorimi në këto bashki janë kryesisht pakicat rome dhe egjiptiane.

Përfshirja dhe aksesueshmëria e personave me aftësi të kufizuara

Deri në vitin 2017, 16% e bashkive të vendit kanë krijuar njësinë për vlerësimin e nevojave dhe referimin për personat me aftësi të kufizuara; 63% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim për vlerësimin e nevojave dhe referimin. Numri mesatar i punonjësve socialë në bashki për shërbimin ndaj personave me aftësi të kufizuara është 5; 23% e bashkive të vendit kanë hartuar një plan vendor veprimi për këtë grup në nevojë.

Në 52% të bashkive infrastruktura PAK është e pranishme vetëm në një pjesë të shkollave në territorin e tyre. Në 21% infrastruktura mungon në të gjitha shkollat dhe asnjë bashki nuk është duke ndërmarrë investime për pajisjen e tyre.

Integrimi i romëve dhe egjiptianëve

Deri në vitin 2017, një plan vendor veprimi në zbatim të planit kombëtar të veprimit në këtë fushë është hartuar në 21% të bashkive të vendit. Megjithatë, 78% e bashkive të vendit nuk ka nëpunës të trajnuar për zbatimin e planit kombëtar, gjithashtu, 41% e bashkive nuk kanë vendosur ende një bashkëpunim me ministritë e linjës në formën e konsultimeve për zhvillimin e programeve vendore për zbatimin e masave të planifikuara në këtë plan. Në 23% të bashkive bashkëpunimi është vendosur, dhe në 13% të bashkive bashkëpunimi është i vazhdueshëm.

38% e bashkive kanë vendosur bashkëpunim me drejtoritë arsimore rajonale me qëllim identifikimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë në moshën shkollore; gjithashtu, 25% e tyre kanë vendosur bashkëpunim e zyrat rajonale të punësimit për punësimin e romëve dhe egjiptianëve ose me drejtoritë rajonale arsimore

për trajnimin profesional të tyre, me qëllim përgatitjen për në tregun e punës. Pjesa më e madhe e bashkive të vendit nuk kanë ende bashkëpunim me asnjërin prej strukturave rajonale të ministrive të linjës, me qëllim integrimin e dy komuniteteve.

Forcimi i sistemit për sigurimin e barazisë gjinore

Deri në vitin 2017, në 75% të bashkive të vendit është krijuar një strukturë që përgjigjet për barazinë gjinore, ndërsa në 84% të tyre është vendosur një koordinator vendor për barazinë gjinore, pavarësisht nëse ka gjithashtu një strukturë të posaçme apo jo.

76% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim nga ministria e linjës për Mekanizmin Kombëtar të Referimit në këtë fushë. Në 24% të tyre nuk ofrohet ende asnjë shërbim i specializuar për gratë viktime të dhunës në familje; mesatarisht në nivel kombëtar ofrohen 2 shërbime të specializuara, numri më i madh i ofruar është 6 shërbime.

Objektiva gjinorë janë përcaktuar në 30% të bashkive të vendit në programin buxhetor afatmesëm, ndërsa në 70% të tyre nuk janë përcaktuar ose nuk ka të dhëna.

36% e bashkive bashkëpunojnë me shoqërinë civile për raste të barazisë gjinore në territorin e tyre kryesisht në formën e organizimit të aktiviteteve të përbashkëta. Nga ana tjetër, në 44% të bashkive të vendit nuk ka organizata vendore të shoqërisë civile me të cilat të mund të vendoset një marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e barazisë gjinore.

Drejtësia, liria dhe siguria

Zhvillimi i luftës kundër krimit të organizuar

Deri në vitin 2017, 51% e bashkive të vendit kanë ngritur një grup pune për zbatimin e Planit të Veprimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar.

Arsimi dhe kultura

Rritja e pjesëmarrjes në klasat përgatitore të arsimit parashkollor

Në vitin 2017, 45% e bashkive të vendit nuk kanë ndërmarrë asnjë fushatë ndërgjegjësimi ndaj prindërve për përfshirjen e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor, ndërsa 72% e bashkive nuk kanë ndërmarrë asnjë investim për zgjerimin e kapaciteteve të çerdheve/kopshteve në bashkinë e tyre.

Përfshirja sasiore dhe cilësore e grupeve të marginalizuara në sistemin e arsimit parauniversitar

Në vitin 2017, asnjë nga bashkitë e vendit nuk ka shpërndarë buxhet për të siguruar regjistrimin dhe vijimin e shkollës së çdo fëmije në moshën shkollore, përmes organizatave të shoqërisë civile, shoqatave të grupeve në nevojë apo drejtorisë arsimore rajonale; 74% e bashkive nuk kanë ndarë buxhet për mbështetjen financiare të fëmijëve në moshën shkollore, familjet e të cilave u përkasin grupeve në nevojë. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore të arsimit parauniversitar

Në vitin 2017, 43% e bashkive të vendit nuk kanë shpërndarë buxhet për rindërtimin e shkollave në territorin e tyre.

Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale

Në vitin 2017, 86% e bashkive të vendit nuk kanë raportuar asnjë rast shkelje dhe ndërtim të jashtëligjshëm në zona pjesë të trashëgimisë kulturore të bashkisë. 70% e bashkive nuk ka shpërndarë buxhet për

mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në territorin e bashkive të tyre.

Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve

Gjatë vitin 2017, bashkitë e vendit kanë organizuar mesatarisht 10 aktivitete kulturore për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtare; mesatarisht bashkitë organizojnë 6 aktivitete të rregullta kalendarike për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtare.

Mjedisi dhe ndryshimi i klimës

Hartimi i planeve të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në nivel vendor

Deri në vitin 2017, 64% e bashkive të vendit nuk kanë hartuar një plan për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe 62% e tyre ende nuk kanë integruar në dokumentet strategjike veprime për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit.

Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve

Deri në vitin 2017, 62% e bashkive të vendit nuk kanë një plan vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Nga 7 bashki të cilat kanë një plan të menaxhimit të integruar të mbetjeve, vetëm 3 mbledhin dhe depozitojnë mbetje në mënyrë të rregullt sipas tij. Ende asnjë bashki nuk kryen ndarjen e mbetjeve në burim sipas rrymave të riciklueshme.

Në 82% të bashkive të vendit nuk ka vend-depozitime të paautorizuara. Mesatarisht bashkitë e vendit kanë 1 vend-depozitim të autorizuar në territorin e tyre.

Forcimi i zbatimit të vendimeve të task forcës për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare

Deri në vitin 2017, 22 bashki nuk kanë ngritur ende një task forcë, ndërsa 83% e bashkive të vendit nuk janë trajnuar nga ministria e linjës në këtë drejtim.

Pyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara

Deri në vitin 2017, në 38% të bashkive të vendit nuk ka një plan veprimi për administrimin e fondit pyjor të territorit. Mesatarisht bashkitë kanë 5 specialistë të administrimit të fondit pyjor në strukturën e tyre.

Kontrolli financiar

Forcimi i kapaciteteve të qeverisë vendore në menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në vitin 2017, në 37 bashki të vendit, këshilli bashkiak ka ndërmarrë mesatarisht 2 kontrole të brendshme. Vërehet një rënie mesatare me 33% e nivelit të detyrimeve të konstatuara dhe të papaguara të bashkive ndaj të tretëve gjatë dy viteve të fundit.

Qeveria vendore dhe programet e BE-së

Ngritja dhe funksionimi i një strukture ndërlidhëse midis BE dhe qeverisë vendore

Deri në vitin 2017, në 77% të bashkive të vendit është ngritura një EU-Desk. Që prej hapjes së tyre mesatarisht 8 qytetarë kanë marrë informacion dhe shërbime; këto zyra kanë organizuar mesatarisht 1 aktivitet

informues dhe komunikimi me komunitetin.

Rritja e njohurive mbi Instrumentin të Ndhmës së Para-Aderimit dhe programe të tjera të BE-së

Në vitin 2017, janë trajnuar mesatarisht 2 nëpunës të administratës vendore; në 30% të bashkive asnjë nëpunës nuk ka marrë pjesë në trajnime me këtë tematikë.

Forcimi i kapaciteteve të qeverisë vendore për të përfituar fondet e BE-së

Në vitin 2017, nga bashkitë e vendit janë kryer mesatarisht 4 aplikime për programe IPA dhe programe të tjera të BE-së për qeverinë vendore dhe janë fituar mesatarisht 2. Megjithatë, 46% e bashkive nuk kanë aplikuar për asnjë program.

I. HYRJE

Ky është raporti i parë kombëtar i hartuar mbi përgjegjësinë e qeverisë vendore në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. I ngritur mbi bazën e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017-2020 dhe Raportit të Komisionit Evropian mbi Shqipërinë, ky raport paraqet gjendjen e përbushjes së çështjeve të lidhura me BE-në, nga ana e qeverisë vendore, në vitin 2017

Raporti vjen 2 vjet pas ndërmarrjes së reformës për decentralizimin dhe qeverisjen vendore dhe ndarjes së re administrative e territoriale të vendit, si një nga komponentët themelorë të saj. Qëllimi i tij është të sjellë në vëmendje të qeverisë qendrore dhe vendore rëndësinë e kësaj të fundit në procesin e integritit të Shqipërisë në BE duke paraqitur përgjegjësinë e saj në drejtim të përbushjes së kriterëve dhe standardeve të anëtarësimit, dhe gjendjen e përbushjes së tyre në vitin 2017, e cila të mund të jetë bazë për vlerësimin e performancës së qeverisë vendore në procesin e integritit në vitet në vazhdim.

II. METODOLOGJIA

Të dhënat për këtë raport janë mbledhur përmes një matrice të strukturuar sipas tre komponentëve si në Raportin e Komisionit Europian (kriteri politik, kriteri ekonomik, aftësia për të përmbushur detyrimet e anëtarësimit), në të cilat qeveria vendore ka përgjegjësi brenda kuadrit të funksioneve të vetëqeverisjes vendore në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Për secilën fushë janë përzgjedhur objektivat të përcaktuar në dokumentet strategjike e politike kombëtare, dhe që, njëkohësisht, janë prioritetet sipas Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2017-2020. Për secilin objektiv janë hartuar tregues të përmbushjes së tyre, të cilët rrjedhin (i) nga këto dokumente ose (ii) nga baza ligjore e fushës përkatëse.

Objektivat që rrjedhin nga dokumentet strategjike e politike kombëtare mund të jenë strategjike ose specifike në dokumentin përkatës të origjinës; në mënyrë të pavarur nga ky përcaktim, në këtë raport ata janë përshkruar specifike në kuptimin e zbatimit të tyre për qeverinë vendore.

Treguesit e secilës fushë janë cilësorë dhe sasiorë. Treguesit sasiorë agregohen në nivel kombëtar nëpërmjet statistikës së mesatares/mjeteve aritmetike. Megjithatë, mesatarja/mjetet aritmetike mund të mos jetë një statistikë e përshtatshme në disa raste për shkak të vlerave shumë të ndryshme të treguesve nga njëra bashki në tjetrën. Për këtë arsye, në secilën prej këtyre rasteve, treguesit sasiorë janë interpretuar së bashku me statistikën e vlerës më të madhe dhe më të vogël. Treguesit cilësorë ndahen në kategori përgjigjesh dhe vlerësohen mbi bazën e frekuencës së përgjigjeve të dhëna për secilën kategori, ndaj numrit të përgjigjeve gjithsej; ata shoqërohen me histogramë në çdo rast.

Matrica është plotësuar nga 60 prej 61 bashkive të vendit gjithsej; ajo nuk është plotësuar vetëm nga Bashkia Finiq. Nga ana tjetër, të dhënat nuk janë plotësuar nga të 60 bashkitë për çdo tregues; gjithashtu, tregues të varur nga përgjigjet e treguesve të tjerë kanë një numër të mundshëm përgjigjesh më të vogël ose të njëjtë me numrin e përgjigjeve të indikatorit me të cilin lidhen, dhe rrjedhimisht dalin më pak ose të njëjtë me 60. Në çdo rast, indikatorët sasiorë janë agreguar vetëm në nivel kombëtar ku numri i përgjigjeve jep një marzh gabimi të agregimit në nivelin 2% - 7,5% me probabilitet 95% të rasteve.

Përkufizime

Bashkëpunimi i bashkisë me institucione qendrore, rajonale apo me OSHC vendore në fusha të caktuara është kuptuar në këtë raport në bazë të numrit të aktiviteteve të zhvilluara bashkërisht, lidhjes së një marrëveshjeje bashkëpunimi, raportimit të rregullt të ndërsjelltë dhe ofrimit të përbashkët të shërbimeve publike vendore.

Kufizime të raportit

Raporti është hartuar mbi bazën e të dhënave të raportuara nga bashkitë, rrjedhimisht, përfundimet e tij mund të jenë të pasakta në ato raste dhe atë masë në të cilën mund të janë të pasakta të dhënat. Duke qenë ushtrimi i parë i këtij lloji në vend, treguesit e hartuar në çdo fushë kanë vend për përmirësim dhe thjeshtim të përshkrimit, ashtu si dhe në çdo fushë ka vend për heqje dhe shtim të treguesve të tjerë. Për shkak të karakterit ndërsektorial të ushtrimit, në rast ripërsëritje të tij në vitet në vazhdim, rekomandohet që procesi i mbledhjes së të dhënave nga bashkitë të shoqërohet me mbështetje të tyre me kapacitete njerëzore.

Në këtë kuadër, përfundimet e këtij raporti nuk janë në vetvete, një vlerësim i performancës së qeverisë vendore në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE, por ato mund të shërbejnë si bazë për ripërsëritje të një ushtrimi të tillë nga Qeveria e Shqipërisë, në vitet në vazhdim.

III. KRITERI POLITIK

Qëndrueshmëria e institucioneve që sigurojnë demokracinë, zbatimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e pakicave

1. Demokracia

Demokracia përmban fushën e qeverisjes, Avokatit të popullit dhe shoqërisë civile, sa i përket qeverisjes vendore.

1.1 Qeverisja

Forcimi i qeverisjes së mirë është një nga qëllimet strategjike të Strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020. Sipas kësaj strategjie, objektivat specifikë të këtij qëllimi, të cilët janë prioritetet e procesit të integritit të vendit në BE, janë zhvillimi i kapaciteteve, rritja e llogaridhënies dhe transparencës si dhe përfshirja e komunitetit në vendimmarrjen e qeverisë vendore.

Objektivi specifik: zhvillimi i kapaciteteve të qeverisë vendore

Administrata publike është në qendër të objektivit për zhvillimin e kapaciteteve të qeverisë vendore. Instrumenti kryesor i përcaktuar në SNDQV për përmbushjen e tij janë trajnimet afatshkurtra dhe afatgjata nga Departamenti i Administratës Publike dhe Shkolla e Administratës Publike. Gjithashtu, në mënyrë të veçantë, për zhvillimin e kapaciteteve të qeverisë vendore është hartuar Strategjia ndërsektoriale e reformës në administratën publike 2015-2020. këtu janë përcaktuar ngritja e zyrave (unike) me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve administrative vendore digjitale (nëpërmjet teknologjisë së informacionit).


Numri mesatar i trajnimeve nga DAP-i mbi legjislaçionin për nëpunësin civil në të cilat bashkitë kanë marrë pjesë është 3, me numër mesatar nëpunësish të administratës prej 12; rreth 29% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim për këtë tematikë.

Numri mesatar i trajnimeve nga SHAP-i me tematikë profesionale në të cilat bashkitë kanë marrë pjesë është 7, me numër mesatar nëpunësish të administratës prej 14. 4% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në trajnime me tematikë profesionale.

Bashkitë kanë marrë pjesë mesatarisht në 2 trajnime mbi Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, me mesatarisht 3 nëpunës të administratës dhe në vetëm 1 trajnim mbi Kodin e Ri të Procedurave Administrative, me 1 nëpunës të administratës; rreth 81% e bashkive nuk kanë zhvilluar asnjë trajnim me këtë tematikë të fundit.

Vlera e buxhetit të bashkive për pjesëmarrjen në këto trajnime ka qenë mesatarisht 485,000 lekë/nëpunës të administratës ose afërsisht 37,300 lekë/trajnim për çdo nëpunës; megjithatë, ky rezultat mund të jetë i mbivlerësuar për shkak të komunikimit jo të saktë nga bashkitë të të dhënave të treguesit. Gjithashtu, rreth 50% e bashkive nuk kanë buxhet të akorduar për pjesëmarrje në trajnime.

Zyrat (unike) me një ndalesë janë ngritur në rreth 31% të bashkive të vendit, ndërsa në 61% të tyre nuk janë ngritur ende; në këtë drejtim në 8% të bashkive nuk ka të dhëna.



Nga ana tjetër, numri mesatar i zyrave me një ndalesë të ngritura në bashkitë e vendit (duke përfshirë njësitë administrative të bashkive) është rreth 1.5; numri më i madh i tyre arrin në 19 zyra të ngritura. Numri mesatar i shërbimeve administrative digjitale të ofruara është rreth 8.5; numri më i madh i ofruar arrin deri në 83 shërbime, por për rreth 52% të bashkive nuk ofrohet ende asnjë shërbim administrativ digjital.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare** dhe njerëzore për ngritjen e zyrave me një ndalesë dhe shtrirjen e tyre në njësitë administrative;
- **Kapacitetet e ulëta financiare** për shtimin e shërbimeve administrative digjitale në zyrat me një ndalesë;
- **Unifikimi në një sistemi të vetëm** elektronik i të gjitha programeve e sistemeve vendore të shërbimeve administrative;
- **Përzgjedhja e punonjësve** të kualifikuar, me kriteret më të përshtatshme sipas specifikimeve të vendit të punës;
- **Zbatimi i njohurive të marra** nga trajnimet në praktikë dhe shkëmbimi i njohurive me kolegë të tjerë; zbatimi i

njohurive të reja mbi Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; përmirësimi i njohurive mbi Kodin e Procedurave Administrative;

- **Kapacitete të ulëta financiare** (di-etat për trajnime) kundrejt nevojave për trajnim për zbatimin e praktikave të ndryshme administrative, përfshirë edhe zbatimin e ligjeve të reja;

- **Kapacitete të ulëta njerëzore** për të harmonizuar dokumentet strategjike të bashkive me programet buxhetore afatmesme;

- **Mungesa e një programi dhe kalendari** trajnimesh për administratën vendore; koordinimi me institucione të qeverisjes qendrore për t'u informuar mbi trajnime të parashikuara për bashkitë.

Objektivi specifik: rritja e llogaridhënies së qeverisë vendore

Mekanizmi i pritjes dhe dhënies së përgjigjeve kërkesave dhe ankesave të qytetarëve nga administrata e bashkive është një mekanizëm bazë i llogaridhënies për një qeverisje të mirë.

Nga ana tjetër, SNDQV përcakton keshillin bashkiak si strukturën administrative vendore përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin e punës së administratës; nëpërmjet keshillit bashkiak dhe kësaj përg-

jegjësie të tij të drejtpërdrejtë, strukturat komunitare përfshihen në përmbushjen e objektivit për rritjen e llogaridhënies së qeverisë vendore, dhe të qëllimit për forcimin e qeverisjes së mirë. Aktualisht, strukturat komunitare janë ende të pa ngritura në bashkitë e vendit .

Strategjia përcakton gjithashtu sistemet e menaxhimit të performancës si instrument të drejtpërdrejtë për rritjen e llogaridhënies së qeverisë vendore, porse nuk i përshkruan më tej ata.

Mbi këtë bazë përmbushja e objektivit është vlerësuar vetëm në lidhje me mekanizmin bazë të pritjes dhe dhënies së përgjigjeve nga administrata e bashkive ndaj qytetarëve. Mesatarisht qytetarët marrin përgjigjeje për kërkesat dhe ankesat e tyre në rreth 75% të rasteve.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare** për ngritjen e një sistemi të integruar për menaxhimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve;
- **Rritja e kapaciteteve njerëzore** të bashkisë për të gjurmuar kërkesat dhe ankesat e paraqitura dhe për të përcaktuar statusin e zgjidhjes së tyre.


Objektivi specifik: rritja e transparencës së qeverisjes vendore

Për transparencën e qeverisjes vendore janë vlerësuar instrumentet që bashkitë kanë mundësuar për t'i dhënë informacion komunitetit të tyre mbi vendimet që ato marrin dhe mbi proceset e vendimmarrjes; nga ana tjetër nuk është vlerësuar niveli i përdorimit ose i aksesit të këtyre instrumenteve nga komuniteti. Kjo do të thotë se treguesit e përzgjedhur nuk vlerësojnë ende rritjen e transparencës së qeverisjes vendore por vetëm realizimin e masave, të cilat janë të përcaktuara në SNDQV për përmbushjen e këtij objekti specifik ose rrjedhin nga detyrime ligjore.

Kështu, është vlerësuar publikimi i vendimeve të bashkisë dhe buxhetit vendor në internet, si dhe zhvillimi i dëgjësive publike mbi financat vendore.

Vendimet e bashkisë gjenden të publikuara në faqen e internetit të bashkisë për pjesën më të madhe të bashkive të vendit: rreth 66% e tyre i publikojnë të gjitha vendimet dhe rreth 13% publikojnë ata më të rëndësishmit; në rreth 16% të bashkive ende nuk publikohet asnjë vendim në faqe.


■ Të gjithë ■ Asnjë
■ Më të rëndësishmit ■ Nuk ka të dhëna



Grafiku 2:

Vendime të bashkisë të publikuara në faqen e internetit të bashkisë

Buxheti vendor i bashkive gjithashtu publikohet në rreth 75% të bashkive të vendit në faqen e internetit të bashkisë ose në faqen financatvendore.al; edhe në këtë rast, në një grup bashkish që përbëjnë rreth 21% bashkive të vendit ende nuk publikohet buxheti vendor në asnjë nga këto dy faqe të internetit.



Numri mesatar i dëgjesave publike të zhvilluara gjatë procesit të hartimit të programit buxhetor afatmesëm në bashkitë e vendit është rreth 5; numri më i madh i zhvilluar është 21, ndërsa në rreth 7% të bashkive nuk është zhvilluar asnjë dëgjesë publike gjatë këtij procesi. Gjithashtu, numri mesatar i dëgjesave publike të organizuara nga bashkia mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara është rreth 6; numri më i madh i tyre arrin në 30, të zhvilluara në nivel lagjeje dhe fshati, ndërkohë që, edhe për këtë pjesë të sektorit të financave vendore, rreth 14% të bashkive nuk kanë organizuar asnjë dëgjesë publike.

Përkrah këtyre mjeteve të rritjes së transparencës së qeverisë vendore, qëndron dhe përgatitja e një buxheti për qytetarët – buxheti vendor i strukturuar në një formë të lexueshme prej tyre. Ende asnjë bashki në vend nuk përgatit një buxhet të tillë. Megjithatë ka nisma për publikimin në faqen e internetit të bashkisë të përshkrimeve dhe vlerave të buxhetit vendor në forma të lexueshme për qytetarët, kryesisht shpenzimet kapitale.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare** dhe njerëzore për ngritjen dhe përditësimin faqes së internetit të bashkisë;
- **Rritja e kapaciteteve njerëzore** për përdorimin e instrumenteve digjitale të transparencës me qytetarët;


- **Ndërgjegjësimi i komunitetit për të qenë** sa më aktiv në informimin mbi buxhetin vendor dhe vendimeve të tjera bashkiake;
- **Thjeshtimi i termave specifikë** financiarë për qytetarët gjatë dëgjesave publike.

Objektivi specifik: përfshirja e komunitetit në vendimmarrjen e qeverisë vendore

Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje është vlerësuar nëpërmjet pjesëmarrjes në procesin e përgatitjes së programit buxhetor të bashkive, si një nga proceset më bazë vendimmarrëse të qeverisë vendore dhe që lidhet drejtpërdrejt me komunitetin.

Në dëgjuesat publike për përgatitjen e PBA-së kanë marrë pjesë mesatarisht rreth 23 qytetarë, numri më i madh i pjesëmarrjes arrin në 88 qytetarë; numri më i vogël arrin në 3. Për numrin e grupeve në nevojë të përfaqësuar prej organizatave të shoqërisë civile nuk ka të dhëna në afërsisht gjysmën e bashkive të vendit. Në pjesën tjetër të bashkive janë përfaqësuar mesatarisht rreth 3 grupe në nevojë; megjithatë, për shkak të numrit të vogël të përgjigjeve, nuk është i mundur përgjithësimi i kësaj mesatareje në nivel kombëtar.

Dëgjuesat publike përdoren mesatarisht në rreth 46% të bashkive të vendit si forma e vetme për përfshirjen e komunitetit të tyre në procesin e përgatitjes së PBA-së; së bashku me forumet e diskutimit me grupet shoqërore brenda komunitetit (grupet në nevojë dhe grupe të tjera të interesit) ato përbëjnë dy format kryesore, të përdorura mesatarisht në rreth 74% të bashkive të vendit. Strukturat komunitare, ngritja e të cilave është objektiv specifik i SNDQV, janë ngritur në vetëm 1 bashki. Takimet me kryetarin janë të mundshme për këtë qëllim gjithashtu vetëm në 1 bashki.



Në 7% të bashkive të vendit nuk përdoret ende asnjë formë për përfshirjen e komunitetit në procesin e përgatitjes së PBA-së, ndërsa në 11% të bashkive nuk ka të dhëna.



Problematika dhe sfida

- **Mungesë e forumeve si struktura** nëpërmjet të cilave qytetarët dhe shoqëria civile vendore mund të marrin pjesë gjatë proceseve të vendimmarrjes së bashkive;
- **Mungesa ende** e strukturave komunitare;
- **Realizimi i buxhetimit** me pjesëmarrje.

1.2 Avokati i Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit është thelbësor për përmirësimin e qeverisjes në nivel vendor nëpërmjet kontrollit të veprimtarisë së administratës publike kundrejt qytetarëve në bazë të ankesave të paraqitura prej tyre.

Objektivi specifik: përmirësimi i shqyrtimit nga bashkia i raporteve të konstatimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit

Në nivel kombëtar, numri mesatar i raporteve të konstatimeve ose rekomandimeve që Avokati i Popullit ka dorëzuar pranë bashkive në vitin 2017 ka qenë 7 dhe gjithashtu 7 është numri mesatar i raporteve të pranuar nga bashkia; numri më i madh i raporteve të marra arrin në 102, nga ana tjetër, rreth 41% e bashkive nuk kanë marrë asnjë raport nga Avokati i Popullit.

Mesatarisht vetëm 1 prej tyre ka qëndruar në proces shqyrtimi nga bashkia përtej afatit kohor të përcaktuar me ligj; numri më i madh arrin në 10.



Problematika dhe sfida

- **Hartimi i një manuali veprimi** për bashkinë për shqyrtimin e raporteve të konstatimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

1.3 Shoqëria civile

Shoqëria civile është gjithashtu një strukturë thelbësore për përmirësimin e qeverisjes në nivel vendor nëpërmjet pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes dhe monitorimit e vlerësimit të këtij procesi dhe performancës së qeverisjes vendore.

Objektivi specifik: konsolidimi i shoqërisë civile në nivel vendor

Për afërsisht gjysmën e bashkive të vendit nuk ka të dhëna për numrin e rekomandimeve të marra nga OSHC-të gjatë procesit të vendimmarrjes vendore dhe për numrin e rekomandimeve të pranuar, pra që kanë ndikuar në vendimmarrje. Për pjesën tjetër të bashkive ky numër arrin në mesatarisht 2 rekomandime; megjithatë, për shkak të numrit të vogël të përgjigjeve, nuk është i mundur përgjithësimi i kësaj mesatareje në nivel kombëtar.



Problematika dhe sfida

- **Mungesë e OSHC-ve** vendore, veçanërisht në bashkitë e vogla;
- **Specializim i ulët i OSHC-ve** vendore në fusha që lidhen me funksionet vendore, e për rrjedhojë, mundësi e kufizuar për të ndikuar në mënyrë të vlefshme në vendim-

marrjen e bashkive;

- **Ngritja e një regjistri/baze** të dhënash për pjesëmarrjen e OSHC-ve vendore në proceset e vendimmarrjes së bashkive;
- **Mungesë e forumeve** si struktura nëpërmjet të cilave shoqëria civile mund të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes së bashkive.

PERFUNDIME MBI DEMOKRACINE

Në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve të qeverisë vendore, gjatë vitit 2017, administrata vendore është trajnuar më shumë për tematika profesionale me mesatarisht 7 trajnime dhe 14 nëpunës të trajnuar. Rreth 29% e bashkive nuk kanë marrë pjesë ende në trajnime mbi legjislacionin për nëpunësin civil, ndërsa rreth 81% e bashkive të vendit nuk janë trajnuar mbi Kodin e Ri të Procedurave Administrative. Rreth 50% e bashkive të vendit nuk shpërndajnë buxhet për nëpunësit për pjesëmarrje në trajnime.

Zyrat me një ndalesë janë ngritur në 19 bashki, të cilat përbëjnë rreth 31% të bashkive të vendit, ndërsa nuk janë ngritur ende në 37 bashki, në rreth 61%. Asnjë shërbim digjital nuk ofrohet ende në rreth 52% të bashkive të vendit.

Në drejtim të rritjes së llogaridhënies së qeverisë vendore, gjatë vitit 2017, mesatarisht qytetarët kanë marrë përgjigje për kërkesat dhe ankesat e tyre në rreth 75% të rasteve; megjithatë dhënia e përgjigjeve zyrtare nuk përfaqëson domosdoshmërisht adresimin e plotë të kërkesës dhe ankesës së qytetarëve dhe nuk përfaqëson as zgjidhjen e problemit që ato përmbajnë. Mungojnë ende sistemet e menaxhimit të performancës së qeverisë vendore. Strukturat komunitare nuk janë ngritur ende.

Në drejtim të rritjes së transparencës së qeverisë vendore, deri në fund të vitit 2017, të gjitha vendimet bashkiake ose ato më të rëndësishme, janë publikuar në faqen e internetit të bashkisë në rreth 79% të bashkive të vendit, pra për pjesën më të madhe të tyre. Numri mesatar i dëgjësave publike të zhvilluara gjatë procesit të hartimit të programit buxhetor afatmesëm është 5, dhe mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara është rreth 6. Ndërsa deri rreth 14% e bashkive të vendit ende nuk organizojnë dëgjesa publike, ka nisma të zhvillimit të tyre deri në nivel lagjeje dhe fshati. Ende asnjë bashki në vend nuk përgatit një buxhet për qytetarët.

Në drejtim të përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen e qeverisë vendore, gjatë vitit 2017, në dëgjesat publike për përgatitjen e PBA-së kanë marrë pjesë mesatarisht rreth 23 qytetarë; për nivelin e pjesëmarrjes së grupeve në nevojë nëpërmjet organizatave të shoqërisë civile nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përfutur një mesatare në nivel kombëtar. Dëgjesat publike dhe forumet e diskutimit me grupet shoqërore brenda komunitetit përbëjnë dy format kryesore të përdorura nga bashkitë për përfshirjen e komunitetit në procesin e përgatitjes së PBA-së ndërsa strukturat komunitare gjerësisht nuk janë ngritur ende.

Në drejtim të përmirësimit të shqyrtimit nga bashkia të raporteve të konstatimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2017, mesatarisht vetëm 1 raport ka qëndruar në proces shqyrtimi përtej afatit kohor të përcaktuar me ligj; nga ana tjetër, rreth 41% e bashkive nuk kanë marrë asnjë raport nga Avokati i Popullit.

Në drejtim të konsolidimit të shoqërisë civile në nivel vendor, për vitin 2017, afërsisht gjysma e bashkive të vendit nuk ka të dhëna për numrin e rekomandimeve të marra nga OSHC-të gjatë procesit të vendimmarrjes së tyre vendore dhe për numrin e rekomandimeve të pranuar.

2. Zbatimi i ligjit

2.1 Lufta kundër korrupsionit

Objektivi specifik: forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave

Për pjesën më të madhe të bashkive të vendit, në rreth 87% të tyre, kryetarët kanë deklaruar pranë ILD-KPKI pasurinë dhe interesat private; me ndryshimet më të fundit të bazës ligjore, kryetarët janë të vetmit zyrtarë të qeverisë vendore që janë subjekt i këtij deklarimi. Për pjesën tjetër, e cila përbën rreth 12%, nuk ka të dhëna.

Raste të konfliktit të interesave të nëpunësve të administratës së bashkive të cilat janë deklaruar, raportohen vetëm në 1 bashki, të shoqëruara me dhënien e dorëheqjes së nëpunësve nga procesi përkatës i punës.

Objektivi specifik: forcimi i kapaciteteve të qeverisë vendore në luftën kundër korrupsionit

Ngritja e rrjetit të koordinatorëve dhe vendosja e pikave të kontaktit anti-korrupsion në bashki janë masa të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit për bashkërendimin e punës në luftën kundër korrupsionit sipas SNKK.

Rrjeti i koordinatorëve vendorë anti-korrupsion në bashki është i ngritur vetëm pjesërisht në bashkitë e vendit, në 36% të tyre, ndërsa në 48% ende jo; në 16% të bashkive nuk ka të dhëna në lidhje me ngritjen e këtij rrjeti.



Gjithashtu, vetëm pjesërisht janë vendosur pikat e kontaktit vendor anti-korrupsion, në 26% të bashkive të vendit; në 46% nuk janë vendosur ende ndërsa në 28% të bashkive nuk ka të dhëna në lidhje me vendosjen e këtyre pikave të kontaktit.



Grafiku 6:

Vendosja e pikave të kontaktit vendor anti-korrupsion në bashki

Në nivel kombëtar mesatarisht bashkitë kanë marrë pjesë në 1 trajnim mbi luftën kundër korrupsionit të organizuar nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit. Regjistri elektronik i bashkisë, si një instrument transparence i zbatueshëm për secilin prej sektorëve të bashkisë, përditësohet në rreth 85% të bashkive të vendit - në mënyrë të rregullt në rreth 64% të tyre. Nga ana tjetër, rreth 5% e bashkive nuk kanë ende një regjistër elektronik ndërsa në 10% të bashkive nuk ka të dhëna.



Grafiku 7:

Shkalla e përditësimit të regjistrit elektronik të bashkisë

Objektivi specifik: artikulimi dhe adoptimi i politikave anti-korrupsion në qeverisjen vendore

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 përcakton objektivin për artikulimin dhe adoptimin e politikave anti-korrupsion në qeverisjen vendore. Për përmbushjen e objektivit janë përcaktuar instrumentet e rritjes së transparencës së qeverisjes vendore si zyrat me një ndalesë e publikimi në internet i vendimeve të bashkisë lidhur me financat vendore; gjithashtu është përcaktuar ngritja e një mekanizmi të monitorimit dhe vlerësimit të ofrimit të shërbimeve publike dhe ndihmës ekonomike në bashki.

Kështu, monitorimi dhe vlerësimi i ndihmës ekonomike nëpërmjet (i) skemës kombëtare ose nga (ii) një komision i posaçëm i bashkisë kryhet në rreth 23% të bashkive të vendit. Për pjesën më të madhe prej 56% të bashkive nuk ka një mekanizëm të monitorimit dhe vlerësimit të këtij shërbimi, ndërsa në rreth 21%


të bashkive nuk ka të dhëna. Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve publike është një funksion i drejtpërdrejtë i qeverisë vendore, i cili përfaqëson një problematikë të përgjithshme të bashkive të vendit por nuk është vlerësuar në mënyrë të veçantë për qëllimin e këtij studimi.

Objektivi specifik: artikulimi dhe adoptimi i politikave anti-korrupsion në qeverisjen vendore

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 përcakton objektivin për artikulimin dhe adoptimin e politikave anti-korrupsion në qeverisjen vendore. Për përmbushjen e objektivit janë përcaktuar instrumentet e rritjes së transparencës së qeverisjes vendore si zyrat me një ndalesë e publikimi në internet i vendimeve të bashkisë lidhur me financat vendore; gjithashtu është përcaktuar ngritja e një mekanizmi të monitorimit dhe vlerësimit të ofrimit të shërbimeve publike dhe ndihmës ekonomike në bashki.

Kështu, monitorimi dhe vlerësimi i ndihmës ekonomike nëpërmjet (i) skemës kombëtare ose nga (ii) një komision i posaçëm i bashkisë kryhet në rreth 23% të bashkive të vendit. Për pjesën më të madhe prej 56% të bashkive nuk ka një mekanizëm të monitorimit dhe vlerësimit të këtij shërbimi, ndërsa në rreth 21% të bashkive nuk ka të dhëna.

Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve publike është një funksion i drejtpërdrejtë i qeverisë vendore, i cili përfaqëson një problematikë të përgjithshme të bashkive të vendit por nuk është vlerësuar në mënyrë të veçantë për qëllimin e këtij studimi.



Grafiku 8:

Ngritja e një mekanizmi monitorimi dhe vlerësimi të ofrimit të ndihmës ekonomike në bashki



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta njerëzore** për zbatimin në nivel vendor të strategjisë kombëtare kundër korrupsionit dhe për hartimin e një plani vendor veprimi në harmoni me këtë strategji;
- **Mungesë e trajnimeve të administratës** vendore nga autoritetet qendrore (Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit).

PERFUNDIME MBI ZBATIMIN E LIGJIT

Në luftën kundër korrupsionit, ***në drejtim të forcimit të regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe konfliktit të interesave***, gjatë vitit 2017, në rreth 87% të bashkive të vendit, kryetarët kanë deklaruar pranë ILDKPKI pasurinë dhe interesat private.

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve të administratës vendore në luftën kundër korrupsionit deri në vitin 2017, rrjeti i koordinatorëve vendorë anti-korrupsion është i ngritur në 36% të bashkive të vendit, ndërsa pikat e kontaktit vendor anti-korrupsion janë vendosur në 26% të tyre. Bashkitë kanë marrë pjesë në mesatarisht 1 trajnim të organizuar nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit.


Në drejtim të artikullimit dhe adoptimit të politikave anti-korrupsion në qeverisjen vendore, deri në vitin 2017, për pjesën më të madhe prej 56% të bashkive të vendit nuk ka një mekanizëm të monitorimit dhe vlerësimit të ndihmës ekonomike.

3. Të drejtat e njeriut

Objektivi specifik: forcimi i kapacitetit të qeverisë vendore për të zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Në nivel kombëtar numri mesatar i trajnimeve mbi standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të organizuara nga autoritetet qendrore ose shoqëria civile në të cilat bashkitë kanë marrë pjesë është 1, dhe numri mesatar i nëpunësve të trajnuar është 4.

Për identifikimin dhe adresimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut rreth 49% bashkive kanë bashkëpunim të mirë me organizatat e shoqërisë civile; rreth 10% kanë një bashkëpunim shumë të mirë. Nga ana tjetër është i lartë numri i bashkive që nuk kanë bashkëpunim në këtë drejtim, për rreth 28% dhe gjithashtu, një pjesë e vogël prej 5% kanë bashkëpunim të dobët në këtë drejtim. Në rreth 8% të bashkive nuk ka të dhëna.



Grafiku 9:

Niveli i bashkëpunimit të bashkisë me OSHC-të në fushën e të drejtave të njeriut



Problematika dhe sfida

- **Mungesë e OSHC-ve** vendore të specializuara në këtë fushë;
- **Identifikimi i rasteve** të shkeljeve të të drejtave të njeriut në zonat rurale, krye-

sisht për shkak të infrastrukturës së dobët rrugore në këto zona;

- **Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore** në fushën e të drejtave të njeriut;
- **Qëndrueshmëria e shërbimeve** të bashkive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

PERFUNDIME MBI TE DREJTAT E NJERIUT

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve të qeverisë vendore për të zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, gjatë vitit 2017, bashkitë kanë marrë pjesë mesatarisht në 1 trajnim të organizuar nga autoritetet qendrore ose shoqëria civile me 4 nëpunës të trajnuar. Rreth 49% bashkive kanë bashkëpunim të mirë me organizatat e shoqërisë civile për identifikimin dhe adresimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut, nga ana tjetër, rreth 28% e bashkive nuk kanë bashkëpunim në këtë drejtim.

IV. KRITERI EKONOMIK

Ekonomi tregu funksionale dhe aftësia për t'u përballur me konkurrencën dhe forcat e tregut të BE-së

1. Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Objektivi specifik: përmirësimi i mjedisit për biznese

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë së një vendi; mbi këtë bazë, krijimi i një klime të favorshme biznesi është prioritet i procesit të integritit të vendit në BE, i cili, njëkohësisht, përputhet me funksionin e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor.


Bashkitë në 74% të rasteve kanë përgatitur një dokument strategjik zhvillimi të bashkisë; kjo pjesë përbën 45 bashki gjithsej, nga të cilat 36 janë bashkitë e mbështetura nga qeveria qendrore ose donatorë për hartimin e planit të përgjithshëm vendor të tyre; 9 bashkitë e tjera mund të kenë një dokument strategjik zhvillimi të territorit të ri të bashkisë, gjithashtu të hartuara më mbështetjen e donatorëve të huaj. Ndërkohë, rreth 25% e tyre nuk kanë përgatitur apo planifikuar një dokument të tillë, ndërsa, në 2% të bashkive nuk ka të dhëna.



Rreth 16% e bashkive kanë zhvilluar aktivitete për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; pjesa më e madhe e tyre, 79% nuk kanë zhvilluar aktivitete të tilla, ndërsa në 5% të bashkive nuk ka të dhëna.




Vetëm 18% e bashkive kanë ofruar shërbime mbështetëse për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; pjesa më e madhe e tyre, 79% nuk kanë ofruar shërbime të tilla gjatë vitit të fundit, ndërsa, në rreth 3% të bashkive nuk ka të dhëna në këtë drejtim.



Pjesa dërmuese e bashkive, 96%, nuk kanë planifikuar buxhet për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme gjatë vitit të kaluar. Vlera më e madhe e buxhetit të planifikuar në këtë drejtim është 2,600 mijë lekë; megjithatë, ky rezultat mund të jetë i mbivlerësuar ose nënvlerësuar për shkak të komunikimit jo të saktë nga bashkitë i të dhënave të treguesit.

Zyrat për zhvillimin dhe promovimin e turizmit janë ngritur dhe janë funksionale në rreth 57% të bashkive të vendit dhe në 38% të tyre nuk janë ngritur ende; në këtë drejtim, në rreth 5% të bashkive nuk ka të dhëna



Grafiku 13:

Zyra për promovimin dhe zhvillimin e turizmit, e ngritur dhe funksionale



Problematika dhe sfida

- **Kapacitetet e ulëta financiare** për hartimin dhe zbatimin e një strategjie zhvillimi të bashkisë;
- **Kapacitetet e ulëta financiare** për mbështetjen e bizneseve të reja (ndërmarrje të vogla dhe të mesme) me lehtësi financiare dhe krijimi i një granti konkurrues

për to;

- **Kapacitetet e ulëta financiare** për ngritjen e një baze të dhënash të saktë për bizneset;
- **Kapacitetet e ulëta financiare** për ngritjen e pikave të informimit në bashki si dhe koordinimi me agjencitë turistike dhe bizneset turistike për të pasur statistika të sakta për turistët.

PERFUNDIME MBI EKZISTENCEN E NJE EKONOMIE TREGU FUNKSIONALE

Në drejtim të përmirësimit të mjedisit të biznesit, deri në vitin 2017, rreth 74% e bashkive të vendit kanë përgatitur një dokument strategjik zhvillimi të bashkisë. Nga ana tjetër, rreth 79% e tyre nuk kanë ndërmarrë asnjë aktivitet për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe nuk kanë ofruar asnjë shërbim mbështetës për zhvillimin e tyre. Rreth 96% e bashkive, nuk kanë shpërndarë buxhet për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Zyrat për zhvillimin dhe promovimin e turizmit janë ngritur dhe janë funksionale në 35 bashki, të cilat përbëjnë rreth 57% të bashkive të vendit, ndërsa nuk janë ngritur ende në 23 bashki, në rreth 38% të tyre.


IV. AFTESIA PER TE MARRE PERSIPER DETYRIMET E ANETARESISE

Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësisë, në mënyrë të veçantë aftësia për të zbatuar me efektivitet rregullat, standardet dhe politikat e acquis, si dhe përkushtimi ndaj bashkimit politik, ekonomik dhe monetar

1. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Objektivi specifik: forcimi i kapaciteteve të qeverisë vendore në sistemin e informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural

Zyrat e Informacionit Bujqësor dhe Zyrat Këshilluese janë ngritur në rreth 62% të bashkive të vendit, ndërsa mungojnë ende në 34% të tyre; në rreth 4% të bashkive nuk ka të dhëna.



Bashkitë ka marrë pjesë mesatarisht në 2 trajnime për prioritetet kombëtare në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimin rural - konkurrueshmëria e sektorit të bujqësisë dhe përmirësimi i teknikave të prodhimit, të cilat janë në përputhje me procesin e integritimit në BE. Megjithatë këtu përfshihen dhe bashkitë të cilat nuk kanë ngritur ende një zyrë informacioni dhe këshillimore, pra dhe nuk kanë ende një strukturë për përbushjen e qëllimit të këtyre trajnimeve.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare** për ngritjen dhe funksionimin e zyrave të informacionit bujqësor dhe zyrave këshilluese në bashki;
- **Kapacitete të ulëta financiare** për ngritjen e një bazë të dhënash të fushës;
- **Kapacitete të ulëta financiare** dhe

njerëzore për hartimin e strategjive bujqësore në nivel vendor në harmoni me strategjinë kombëtare; njohuri të pamjaftueshme mbi strategjinë kombëtare;

- **Bashkëpunimi me organizata** këshillimore të specializuara në këtë fushë;
- **Pajisja e të gjithë fermerëve** me certifikata pronësie;
- **Infrastrukturë rrugore** e dobët në zona të thella rurale.


Objektivi specifik: përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë: përmirësimi i infrastrukturës rurale, zhvillimi i balancuar territorial dhe ekonomik i zonave rurale

Përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë është objektivi strategjik i Strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020. Përmirësimi i infrastrukturës së zonave rurale si dhe zhvillimi i balancuar territorial dhe ekonomik i tyre janë prioritete të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian të cilat i shërbejnë arritjes së këtij objektivi; nëpërmjet funksionit të drejtpërdrejtë të qeverisë vendore në fushën e infrastrukturës rrugore, bashkitë kanë rol në arritjen e të dy këtyre prioriteteve dhe, rrjedhimisht, të objektivit strategjik.

Vetëm rreth 10% e bashkive të vendit kanë një rrjet të plotë dhe lehtësues të rrugëve për lidhjen e zonave bujqësore të bashkisë me qendrat tregtare të saj dhe të bashkive fqinje. Pjesa më e madhe e tyre, rreth 57% nuk kanë një rrjet të plotë ose gjendja e tij nuk lehtëson lidhjen e zonave bujqësore, ndërsa rreth 21% kanë një rrjet të pjesshëm ose pjesërisht lehtësues. Për këtë tregues rreth 11% e bashkive nuk kanë të dhëna.



Nga ana tjetër, që prej fillimit të zbatimit të Reformës Administrative dhe Territoriale në vend në vitin 2016, për rreth 49% të bashkive të vendit nuk ka pasur buxhet të posaçëm për ndërtimin e këtij rrjeti rrugor, ndërsa për 3% të tyre buxheti nuk ka ndryshuar. Nga ana tjetër, nuk raportohet rënie e buxhetit nga asnjë bashki, madje në 33% të tyre buxheti është rritur. Në 15% e bashkive nuk ka të dhëna.



Njëkohësisht, sasia mesatare e granteve për bujqësinë dhe zhvillimin rural që prej fillimit të zbatimit të RAT në vitin 2016 është afërsisht 9,260,000 lekë ose 4,630,000 lekë në vit; megjithatë, ky rezultat mund të jetë i mbi ose nënvlerësuar për shkak të komunikimit jo të saktë nga bashkitë të të dhënave të treguesit.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare** për përmirësimin e rrjetit rrugor të zonave rurale;
- **Vendosja e një bashkëpunimi ndër-bashkiak** për lidhjen e prodhimit bujqësor me tregjet rajonale;
- **Gjetja e hapësirave të reja publike** dhe vendosja e një partneriteti publik privat për ndërtimin e tregjeve të reja rajonale.

Objektivi specifik: rivendosja, ruajtja dhe zhvillimi i ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe pyjet
Rreth 10% e bashkive të vendit kanë një plan vendor (ose janë në hartim e sipër) për natyrën dhe biodiversitetin në territorin e tyre; këto janë kryesisht plane për ruajtjen dhe zhvillimin e ekosistemeve brenda territorit të bashkive me qëllim mbrojtjen e mjedisit, si lumenj ose pyje, por jo për ekosisteme të varura nga bujqësia.
Rreth 78% e bashkive të vendit nuk kanë një plan për natyrën dhe biodiversitetin, ndërsa në rreth 7% të bashkive nuk ka të dhëna.



Grafiku 17:

Plan vendor i hartuar për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit në bashki



Problematika dhe sfida

- **Rritja e kapaciteteve financiare** dhe njerëzore për hartimin dhe zbatimin e një plani vendor për natyrën dhe biodiversitetin në bashki, që është i varur nga bujqësia;
- **Ndërgjegjësimi i komunitetit** për mirëmbajtjen e kullotave dhe pyjeve.

PERFUNDIME MBI BUJQESINE DHE ZHVILLIMIN RURAL

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve të qeverisë vendore në sistemin e informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, deri në vitin 2017, Zyrat e Informacionit Bujqësor dhe Zyrat Këshilluese janë ngritur në rreth 62% të bashkive të vendit, ndërsa mungojnë ende në 34% të tyre.

Në drejtim të përmirësimit të produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë, deri në vitin 2017, rreth 57% e bashkive të vendit nuk kanë një rrjet të plotë ose lehtësues të rrugëve për lidhjen e zonave bujqësore me qendrat tregtare të tyre dhe të bashkive fqinje, ndërsa rreth 21% kanë një rrjet të pjesshëm ose pjesërisht lehtësues. Që prej fillimit të zbatimit të Reformës Administrative dhe Territoriale, buxheti për ndërtimin e këtij rrjeti rrugor është rritur në rreth 33% të bashkive të vendit, ndërsa për rreth 49% të tyre nuk ka pasur buxhet të posaçëm për këtë qëllim.

Në drejtim të rivendosjes, ruajtjes dhe zhvillimit të ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe pyjet, deri në vitin 2017, vetëm rreth 10% e bashkive të vendit kanë, ose janë në hartim e sipër, të një plani vendor për natyrën dhe biodiversitetin në territorin e tyre; këto janë kryesisht plane për ruajtjen dhe zhvillimin e ekosistemeve brenda territorit të bashkive me qëllim mbrojtjen e mjedisit, si lumenj ose pyje, por jo për ekosisteme të varura nga bujqësia.

2. Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare

Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nuk përcakton funksion të qeverisë vendore në fushën e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare.

Kjo fushë rregullohet me ligjin 9863, 28.01.2008 “Për ushqimin”, ligjin 10465, 29.12.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjin 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”. Qëllimi dhe nenet e ligjit për ushqimin dhe për mbrojtjen e bimëve nuk përfshijnë qeverinë vendore. Ndërkohë, qëllimi i ligjit për shërbimin veterinar e përfshin qeverinë vendore, me nenet 19, 22, 24, 54, 61, 80 dhe 128, të cilët ngarkojnë përgjegjësi dhe kompetenca mbi qeverinë vendore, dhe rregullojnë rolin e saj në procesin e menaxhimit dhe monitorimit brenda sektorit. Veçanërisht VKM 230 / 20.03.2013, bazuar në ligjin 10465, është me rëndësi për rolin e qeverisë vendore në shërbimin veterinar.

Në nivel kombëtar strategjik dhe politik, zhvillimi i sektorit planifikohet në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020. Kjo strategji përcakton në paragrafin 1.7.2 qeverinë vendore si një nga autoritetet kompetente të përfshira në menaxhimin e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare në vend, si dhe përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat e saj për shërbimin veterinar, bazuar në ligjin 10465.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, Raporti i Komisionit Evropian, ashtu si dhe SNZHRB, vërejnë se, megjithëse sektori ka filluar reformimin duke harmonizuar legjislacionin e mëparshëm me acquis të BE-së, rezultati i të cilit është baza e mësipërme ligjore, përgjegjësitë e përbashkëta të institucioneve qeveritare nuk janë të qarta, ende jo në përputhje me reformën e re territoriale administrative, dhe, rrjedhimisht, kjo bazë ligjore ka nevojë të rishikohet.


Në këto kushte, vendosja e objektivave për qeverinë vendore në këtë fushë është bërë në ndjekje të SNZHRB-së dhe ligjit 10465, duke qenë kuadri strategjik e ligjor ende në fuqi. Megjithatë, meqenëse fusha nuk është pjesë e funksioneve të vetëqeverisjes vendore, gjithashtu sipas ligjit në fuqi, ky kapitull i raportit është i diskutueshëm dhe ka vend për rishikim.

Objektiv specifik: përmirësimi i kushteve sanitaro-veterinare me qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve

Numri mesatar i inspektorëve veterinerë në strukturën e një bashkie është 3; numri më i madh i inspektorëve është 26, ndërsa rreth 2% e bashkive nuk kanë asnjë veteriner në strukturën e administratës së tyre.

Numri mesatar i inspektorëve veterinerë të trajnuar mbi kërkesat e BE në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë është 1; numri më i madh i trajnuar është 26, por pjesa më e madhe e bashkive, 54%, nuk është trajnuar mbi këtë tematikë.

Inspektorët veterinerë të bashkive në 43% të rasteve ushtrojnë kontrolle veterinarë çdo ditë në pikat e therjes së mishit; pothuajse çdo ditë këto kontrolle ushtrohen nga 28% e bashkive; në 8% të rasteve kontrollet janë të paktën 1 herë/muaj dhe vetëm në 3% kontrollet ushtrohen më rrallë se 1 herë/muaj. Rreth 5% e bashkive nuk kanë ushtruar kontrolle veterinarë në pikat e therjes së mishit, ndërsa rreth 13% e tyre nuk kanë të dhëna për këtë tregues.



Numri mesatar i rasteve të shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore dhe veterinarë të raportuara tek autoritetet qendrore është 4; numri më i madh i rasteve të shkeljeve të raportuara është 25, ndërsa 51% e bashkive nuk kanë raportuar asnjë rast. Për këtë tregues rezultati nuk mund të përgjithësohet në nivel kombëtar për shkak të numrit të ulët të përgjigjeve, me vetëm 43 bashki.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare** (laboratorë, pajisje) për ofrimin e shërbimit;
- **Rritja e kapaciteteve inspektuese** të subjekteve private (tregtuese të mishit), në përputhje me kërkesat e BE në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë;
- **Kapacitete të ulëta financiare** për krijimin e një regjistri për kafshët endacake;
- **Kapacitete të ulëta financiare** për hapjen e strehëve për kafshët endacake;

- **Rritja e kapaciteteve të stafit** për vendosjen dhe zbatimin e standardeve në thertore për cilësinë dhe sigurinë e mishit të freskët.
- **Paqartësia në kuptimin e bazës** ligjore ekzistuese, ku kompetencat e shërbimit veterinar vendor nuk janë shumë të qarta, duke vështirësuar kështu ushtrimin e këtij funksioni.
- **Bashkëpunimi me institucionet** e veterinarisë dhe sigurisë ushqimore nivel vendor dhe qendror.

PERFUNDIME MBI POLITIKAT E SIGURISE USHQIMORE, VETERINARISE DHE FITOSANITARE

Në drejtim të përmirësimit të kushteve sanitaro-veterinare me qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve, deri në vitin 2017, bashkitë kanë caktuar në strukturën e tyre mesatarisht 3 inspektorë veterinerë. Rreth 54% e bashkive të vendit nuk janë trajnuar ende mbi kërkesat e BE-së në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë. Kontrollat veterinarë ushtrohen çdo ditë dhe pothuajse çdo ditë nga 43 bashki, të cilat përbëjnë rreth 71% të bashkive të vendit. Bashkitë kanë raportuar mesatarisht 4 raste të shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore dhe veterinarë tek autoritetet qendrore; ndërsa, 22 bashki, të cilat përbëjnë 51% të bashkive të vendit, nuk kanë raportuar asnjë rast të tillë.

3. Kapitulli 14: Politika e transportit

Në fushën e politikave të transportit rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor është prioritet i procesit të integritetit të vendit në BE.

Objektivi specifik: rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor

Në drejtim të rritjes së sigurisë rrugore në nivel vendor nga bashkitë janë vlerësuar tregues si % e rrjetit rrugor ekzistues të territorit të bashkisë i cili është brenda standardeve ligjore të ndërtimit, % e rrjetit rrugor ekzistues të territorit të bashkisë i cili është brenda standardeve ligjore të sinjalistikës, % e territorit të bashkisë ku shtrihet rrjeti rrugor ekzistues, numri i fshatrave në çdo njësi administrative e lidhur me qendrën e bashkisë nëpërmjet rrjetit rrugor ekzistues, fondi i buxhetit vendor për mirëmbajtjen e rrugëve i planifikuar në PBA si dhe fondi i buxhetit vendor për ndërtimin/rehabilitimin e rrugëve i planifikuar në PBA.

Në nivel kombëtar, mesatarisht 36% e rrjetit rrugor ekzistues të territorit të bashkisë është brenda standardeve ligjore të ndërtimit; përqindja më e lartë për këtë tregues është 90%, në dukje i mbivlerësuar; megjithatë, pjesa më e madhe e bashkive raportojnë përqindje tepër të ulëta të këtij treguesi.

Mesatarisht 61% e territorit të bashkive ka një rrjet rrugor ekzistues; ka bashki të cilat kanë raportuar që 100% i territorit mbulohet nga një rrjet rrugor, ndërsa vlera më e ulët e raportuar është 3%.

Mesatarisht 27% e rrjetit rrugor ekzistues të territorit të bashkisë është brenda standardeve ligjore të sinjalistikës; përqindja më e madhe për këtë tregues është 90%, ndërsa përqindja më e vogël është 0.1%.

Numri mesatar i fshatrave në çdo njësi administrative të lidhur me qendrën e bashkisë nëpërmjet rrjetit rrugor ekzistues është 43; numri më i madh është 141 fshatra, por ka dhe bashki të cilat nuk kanë asnjë fshat të lidhur me qendrën e bashkisë. Treguesi ka nevojë të rivlerësohet duke përfshirë numrin e fshatrave gjithsej të një bashkie.

Vlera e buxhetit të bashkive për mirëmbajtjen e rrugëve i planifikuar në PBA 2018-2020 është mesatarisht 57,674 mijë lekë. Vlera më e lartë e parashikuar në buxhet nga bashkitë është 1,389,775 mijë lekë, por ka dhe bashki të cilat nuk kanë planifikuar asnjë fond më këtë zë.

Mesatarisht bashkitë kanë parashikuar një vlerë prej 257,509 mijë lekë për ndërtimin/rehabilitimin e rrugëve të planifikuar në PBA. Vlera më e lartë e parashikuar në buxhet nga bashkitë është 7,753,936 mijë lekë, por ka dhe bashki të cilat nuk kanë planifikuar asnjë fond më këtë zë, përkatësisht 13%.

Megjithatë, të dyja këto rezultate mund të jetë i mbivlerësuar për shkak të komunikimit jo të saktë nga bashkitë të të dhënave të treguesve.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare** të bashkive për rehabilitimin apo ndërtimin e rrugëve në territoret e tyre sipas standardeve ndërkombëtare
- **Kapacitete të ulëta financiare për hartimin** e planeve afatgjata strategjike dhe planeve të kontrollit;
- **Shtimin e kapaciteteve administrative** kryesisht në sektorin e projekteve;
- **Bashkëpunimi** më i mirë ndërmjet bashkive.

PERFUNDIME MBI POLITIKEN E TRANSPORTIT

Në drejtim të rritjes së sigurisë rrugore në nivel vendor, deri në vitin 2017, mesatarisht 61% e territorit të bashkive të vendit ka një rrjet rrugor ekzistues. Mesatarisht 36% e tij është brenda standardeve ligjore të ndërtimit dhe 27% e tij është brenda standardeve ligjore të sinjalistikës. Rreth 13% të bashkive nuk kanë shpërndarë buxhet për ndërtimin/rehabilitimin e rrugëve.

4. Kapitulli 15: Energjia

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian përcakton si një nga prioritetet e tij në fushën e energjisë miratimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2011-2018; ky plan, mbi bazën e përgjegjësisë ligjore të kryetarit të bashkisë si autoritet përgjegjës për zhvillimin e territorit të saj, i ngarkon bashkive përgjegjësi për rritjen e eficiencës së përdorimit të energjisë në ndërtesat me një banesë dhe shumë banesa dhe në ndërtesat për shërbime private nëpërmjet përmirësimit të zbatimit të kërkesave minimale ligjore për cilësi termike të këtyre ndërtesave. Në këtë drejtim bashkia ngarkohet të punësojë punonjës shtesë, të trajnuar, për të kontrolluar kërkesat e eficiencës së energjisë në ndërtesa.

Objektivi specifik: rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë – në ndërtesat me një banesë dhe shumë banesa dhe ndërtesat për shërbime private

Bashkitë e vendit kanë marrë pjesë në mesatarisht në 1 trajnim të administratës vendore mbi kërkesat minimale ligjore për cilësi termike të ndërtesave me një banesë, shumë banesa, dhe për shërbime private, në kuadër të PKVEE. Disa bashki kanë marrë pjesë nga 7 deri në 10 trajnime, ndërsa rreth 71% deri 75% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim me këto tematika.

Asnjë nga bashkitë e vendit nuk ka punësuar punonjës shtesë për të kontrolluar kërkesat e eficiencës së energjisë në ndërtesa brenda territorit të saj. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e bashkive nuk kanë kryer kontrole për ndërtesat me një dhe shumë banesa dhe për shërbime private; numri më i madh i kryerës është 90, por i gjithë grupi i bashkive të cilat kanë kryer këto kontrole përbën vetëm rreth 9% të numrit të bashkive të vendit.



Problematika dhe sfida

- **Mungesa e kapaciteteve njerëzore** të specializuara në këtë fushë;
- **Mungesë trajnimesh** të administratës vendore për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në këtë fushë;
- **Hartimi i një plani** kontrollueshëm terren;
- **Mungesë mjetesh** për kryerjen e kontrolleve në terren;
- **Shtimi i kapaciteteve** administrative kryesisht në sektorin e projekteve;
- **Bashkëpunimi** më i mirë ndërmjet bashkive.

Objektivi specifik: zbatimi i metodave për përmirësimin e eficiencës së energjisë – në sektorin e banesave

Numri mesatar i shërbimeve të këshillimit për energjinë të ofruara nga bashkia ose për të cilat bashkia ka bashkëpunuar me autoritetet qendrore është 1; numri më i madh i këtyre shërbimeve arrin deri në 20, por për rreth 83% të bashkive shërbime këshillimi për energjinë nuk janë ofruar dhe as nuk ka pasur bashkëpunim me autoritetet qendrore në këtë drejtim.

Objektivi specifik: përdorimi i marrëveshjeve të performancave energjike – për ndërtesat e shërbimit publik dhe për ndriçimin rrugor

Përdorimi nga bashkitë të marrëveshjeve të performancave energjike është ende në hapa fillestarë. Numri mesatar i seminareve me këtë tematikë të mbajtura me bashkitë është 1, numri më i lartë është 4, megjithatë 75% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në asnjë seminar me këtë tematikë.




Problematika dhe sfida

- **Mungesë e trajnimeve** të administratës vendore mbi marrëveshjet e performancave energjike.

Objektivi specifik: përmirësimi i transportit publik

Në sektorin e transportit publik, Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë përcakton nevojën për rritje të kapacitetit të transportit publik vendor për të nxitur reduktimin e përdorimit të automjeteve individuale nga qytetarët.

Në 43% të bashkive të vendit nuk ofrohet shërbimi i transportit publik nga bashkia, por nevojat e qytetarëve për lëvizje plotësohen nga operatorë privatë. Rreth 10% e tyre ofrojnë transport publik dhe publikojnë planin e transportit në stacionet e autobusëve; rreth 30% nuk publikojnë një plan transporti. Në rreth 18% të bashkive nuk ka të dhëna.



Në 16 bashki të vendit, ku ofrohet transport publik, shpeshtësia e mjeteve në linjat urbane është mesatarisht 31.5 minuta; po kështu, në 19 bashki të vendit, ku ofrohet shërbimi, numri mesatar i viteve të punës së mjeteve është 25.



Problematika dhe sfida

- **Futja në qarkullim e mjeteve** që janë prodhuar pas vitit 2000 dhe nxjerrja jashtë tregut të mjeteve para këtij viti prodhimi;
- **Mungesë kapacitetesh njerëzore** për ngritjen e shërbimit të transportit publik në bashki;

- **Mungesë interesi nga operatorët privatë** për disa linja ndërqytetëse;
- **Vendosja e sistemit të biletimit** elektronik në shërbimin e transportit urban;
- **Vendosja e sistemeve inteligjente SIT**, informatizimi i stacioneve,
- **Implementimi i raportimit të sistemit** GPS për vlerësimin e performancës së shërbimit të transportit publik.

Objektivi specifik: promovimi i ecjes në këmbë dhe me biçikleta

Gjithashtu në sektorin e transportit publik është përcaktuar nevoja për të promovuar ecjen në këmbë dhe me biçikleta për të nxitur reduktimin e përdorimit të automjeteve individuale nga qytetarët. Në nivel kombëtar mesatarisht ka rreth 2.4 km rrugë për biçikleta në zonat urbane të bashkive dhe 55% e rrjetit rrugor të brendshëm të tyre është i pajisur me trotuare. Gjatësia më e madhe e rrugëve për biçikleta arrin në 25 km, ndërsa rreth 60% e bashkive nuk kanë asnjë km rrugë për biçikleta. Përqindja më e madhe e rrjetit rrugor të brendshëm të pajisur me trotuare arrin në bashki të caktuara në 90%, porse përqindja më e vogël arrin në vetëm 1%.

Bashkitë kanë organizuar mesatarisht 1 fushatë promovimi të ecjes në këmbë dhe me biçikleta gjatë vitit të fundit, ndërsa rreth 54% e bashkive nuk kanë organizuar asnjë fushatë.



Problematika dhe sfida

- **Mungesë kapacitetesh financiare** për investime madhore në ndërtimin e rrugëve të biçikletave;
- **Shpronësimi i banorëve** dhe trojeve private;
- **Vështirësi teknike** për të ndërhyrë me trotuare në rrugët brenda lagjeve;
- **Ndërgjegjësimi i qytetarëve** mbi rëndësinë e ecjes në këmbë dhe me biçikleta.
- **Shtimin e kapaciteteve** administrative kryesisht në sektorin e projekteve;
- **Bashkëpunimi** dhe koordinimi më i mirë ndërmjet bashkive.

PERFUNDIME MBI ENERGJINE

Në drejtim të rritjes së eficiencës së përdorimit të energjisë, në vitin 2017, rreth 71% deri 75% e bashkive të vendit nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim mbi kërkesat minimale ligjore për cilësi termike të ndërtesave me një banesë dhe shumë banesa, si dhe për shërbime private, përkatësisht. Asnjë nga bashkitë nuk ka punësuar punonjës shtesë për të kontrolluar kërkesat e eficiencës së energjisë në ndërtesa brenda territorit të saj. Rreth 91% e tyre nuk kanë kryer kontrolle për ndërtesat me një dhe shumë banesa dhe për shërbime private.

Në drejtim të zbatimit të metodave për përmirësimin e eficiencës së energjisë, në vitin 2017, në rreth 83% të bashkive shërbime këshillimi për energjinë nuk janë ofruar dhe as nuk ka pasur bashkëpunim me autoritetet qendrore në këtë drejtim.

Në drejtim të përdorimit të marrëveshjeve të performancave energjitike, në vitin 2017, rreth 75% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në asnjë seminar me këtë tematikë.

Në drejtim të përmirësimit të transportit publik, deri në vitin 2017, në 43% të bashkive nuk ofrohet shërbimi i transportit publik nga bashkia, por nevojat e qytetarëve për lëvizje plotësohen nga operatorë privatë; në 16 bashki të vendit, ku ofrohet transport publik, shpeshtësia e mjeteve në linjat urbane është mesatarisht 31.5 minuta; në 19 bashki të vendit, ku ofrohet shërbimi, numri mesatar i viteve të punës së mjeteve është 25.

Në drejtim të promovimit të ecjes në këmbë dhe me biçikleta, deri në vitin 2017, mesatarisht ka rreth 2.4 km rrugë për biçikleta në zonat urbane të bashkive dhe 55% e rrjetit rrugor të brendshëm të tyre është i pajisur me trotuare; rreth 60% e bashkive nuk kanë asnjë km rrugë për biçikleta.


5. Kapitulli 16: Tatimet

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, në fushën tatimeve përcakton objektivin kryesor për përmirësimin e administrimit të tatimeve në rritjen e bazës së tatueshme. Në këtë drejtim njësitë e qeverisjes vendore luajnë një rol të rëndësishëm për sa kohë u garantohet me ligj e drejta për vendosjen e nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve e sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

Objektivi specifik: përmirësimi i administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore në drejtim të rritjes së bazës së tatueshme

Arritja e këtij objekti janë vlerësuar me tregues si politika tatimore të planifikuara/zbatuara të bashkisë që kanë për qëllim nxitjen e formalizimit të ekonomisë në territorin e saj, gjatë vitit të fundit/të planifikuara në PBA, numri i inspektimeve në terren të ndërmarra nga bashkia me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale në territorin e saj gjatë vitit të fundit, numri i dëgjësave publike me grupet e biznesit të organizuara nga bashkia me qëllim informimin dhe përfshirjen në diskutimin e politikave tatimore të bashkisë si dhe ndërtimin e një baze të dhënash (program) të debitorëve të bashkisë e ngritur/efektive.

Politika tatimore për nxitjen e formalizimit të ekonomisë në territorin e një bashkie, gjatë vitit të fundit, janë planifikuar/zbatuar nga 50% e bashkive në rang vendi, 30% nuk kanë planifikuar/zbatuar politika tatimore, ndërsa në rreth 20% e tyre nuk ka të dhëna.




Grafiku 20:

Politika tatimore të bashkisë për nxitjen e formalizimit të ekonomisë në territorin e saj

Numri mesatar i inspektimeve në terren të ndërmarra nga bashkia me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale në territorin e saj gjatë vitit të fundit është 271; megjithatë ky tregues ka luhatje të ndjeshme ndërmjet vlerave të mëdha dhe të vogla; ku numri më i madh i inspektimeve është 2,800 dhe numri më i vogël 2 inspektime.

Numri mesatar i dëgjësave publike me grupet e biznesit të organizuara nga bashkitë me qëllim informimin dhe përfshirjen në diskutimin e politikave tatimore të bashkisë është 4; numri më i madh është 40, por ka dhe bashki që pavarësisht kërkesave ligjore nuk kanë organizuar asnjë dëgjësë publike në këtë drejtim, përkatësisht 11% e tyre.

Baza e të dhënave të debitorëve të bashkisë është e ngritur nga 89% e bashkive të vendit; në përgjithësi këto programe gjenden në formë Excel-i, megjithatë, ka dhe përjashtime të bashkive të cilat kanë ndërtuar një program të dedikuar i cili shërben për administrimin e regjistrit të subjekteve të ndryshme për të gjitha detyrimet tatimore ndaj bashkisë. Rreth 8% e bashkive nuk e kanë ngritur akoma një program për këtë qëllim, ndërsa 3% nuk kanë dhënë përgjigje.



Grafiku 21:

Ngritja e një baze të dhënash të debitorëve të bashkisë



Problematika dhe sfida

- **Kapacitetet e ulëta** financiare për të ngritur një sistem eficient për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore;
- **Rritja e kapaciteteve** inspektuese në terren;
- **Paqartësia në kuptimin** dhe zbatimin e ligjeve nga tatimpaguesit;
- **Rritja e pjesëmarrjes** së qytetarëve dhe shoqërisë civile në dëgjesat dhe

niveli i diskutimit të problemeve;

- **Bashkëveprimi midis institucioneve** të qeverisjes qendrore me ato vendore për të parandaluar ekonominë jo formale;
- **Bashkëpunimi me institucionet** dhe grupet e ndryshme të interesit për ndërtimin e një kadastrë fiskale të saktë dhe fleksibël;
- **Vështirësi në zbatimin** e politikave tatimore për shkak të shtrirjes më të madhe territoriale të bashkisë.

PERFUNDIME MBI TATIMET

Në drejtim të përmirësimit të administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore përmes rritjes së bazës së tatueshme, gjatë vitit 2017, 51% e bashkive të vendit kanë planifikuar/zbatuar politika tatimore për nxitjen e formalizimit të ekonomisë në territorin e tyre; megjithatë, 18 bashki, të cilat përbëjnë rreth 30% të bashkive të vendit, ende nuk kanë hartuar/zbatuar një politikë të tillë tatimore.

Bashkitë kanë ndërmarrë mesatarisht 271 inspektime në terren me qëllim parandalimin e ekonomisë jo formale në vend. Ato kanë organizuar 4 dëgjesa publike me qëllim informimin dhe përfshirjen e biznesit në diskutimin e politikave tatimore të bashkisë; megjithatë, 6 bashki, të cilat përbëjnë 11% të bashkive të vendit, nuk kanë zhvilluar asnjë dëgjese.

Baza e të dhënave të debitorëve të bashkisë është e ngritur nga 54 bashki, të cilat përbëjnë 89% të bashkive të vendit; një bazë e tillë nuk është ngritur ende në 5 bashki të vendit.

6. Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi


Zhvillimi strategjik i fushës së mbrojtjes sociale të grupeve në nevojë është i përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020, e cila ndan përgjegjësinë për këtë fushë mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore; përgjegjësia që i ngarkohet qeverisë vendore përputhet me funksionet e drejtpërdrejta të saj në fushën e shërbimeve sociale në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Strategjia planifikon një qasje aktive ndaj mbrojtjes sociale të grupeve në nevojë nëpërmjet lidhjes së shërbimeve për mbrojtjen sociale me programet aktive të punësimit, me qëllim përfundimtar parandalimin dhe ri-integrimin e grupeve në nevojë në shoqëri dhe në ekonominë e vendit. Instrumentet bazë për përmbushjen e kësaj qasjeje të planifikuar në Strategji janë ndihma ekonomike për zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë, pagesa për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimet e kujdesit social për grupet në nevojë të ndërlidhura me arsimin profesional dhe punësimin. Mbi këtë bazë, janë përcaktuar dy objektivat në vijim për qeverinë vendore:

Objektivi specifik: mbrojtja sociale në nivel vendor

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 është kërkuese në lidhje me shtimin e shërbimeve të kujdesit social, për rrjedhojë dhe të nëpunësve vendorë që mbulojnë sektorin. Mbi këtë bazë, numri mesatar i nëpunësve të administratës vendore që i janë shtuar strukturës së bashkive të vendit për mbrojtjen sociale është 3; numri më i madh arrin në 35, megjithatë, në rreth 47% të bashkive nuk ka asnjë nëpunës të shtuar për të mbuluar këtë fushë. Gjithashtu, numri mesatar i nëpunësve që i janë shtuar strukturës së bashkive për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës kombëtare të ndihmës ekonomike është 2, numri më i madh është 12, porse edhe për këtë, në rreth 43% të bashkive nuk ka asnjë nëpunës të shtuar. Nga ana tjetër, numri mesatar i nëpunësve të trajnuar në bashkitë e vendit mbi strategjinë kombëtare për mbrojtjen sociale dhe përgjegjësinë që ajo i ngarkon bashkive është 6, ndërsa rreth 14% të tyre nuk kanë asnjë nëpunës të trajnuar.


Një sektor për vlerësimin e nevojave dhe referimin për shërbime të kujdesit social është ngritur në rreth 26% të bashkive të vendit, ndërsa ende jo në rreth 69% të tyre; për rreth 5% të bashkive nuk ka të dhëna në këtë drejtim.



Gjithashtu, në nivel kombëtar, numri mesatar i raporteve të performancës së shërbimeve të kujdesit social për PAK është më i vogël se 1, dhe në rreth 84% të bashkive nuk është hartuar asnjë raport.

Përqindja mesatare e të ardhurave vendore e planifikuara për shpenzime të kujdesit social në vitin 2017 për 44 bashki të vendit është rreth 2 %; përqindja më e madhe arrin në 19%, gjithsesi, mesatarja nuk mund të përgjithësohet në nivel kombëtar për shkak të numrit të vogël të përgjigjeve.

Rreth 57% e bashkive të vendit kanë një bazë të dhënash statistikore për shërbimet e kujdesit social që ato ofrojnë, ndërsa rreth 30% e tyre nuk kanë ende. Për rreth 13% të bashkive nuk ka të dhëna. SKMS planifikon ngritjen e një sistemi të integruar informacioni në nivel qendror dhe rajonal (Sistem Menaxhimi Informacioni) për shërbimet e kujdesit social; mbi këtë bazë, duke qenë se treguesi nuk qartëson bazën e të dhënave për të cilën pyeten bashkitë, nuk mund të përfundohet që 57% e bashkive kanë një bazë të dhënash sipas sistemit të integruar të informacionit të planifikuar në SKMS.




Grafiku 23:

Bazë të dhënash statistikore mbi shërbimet e kujdesit social të ofruara nga bashkia

Në rreth 48% të bashkive të vendit nuk ka një qendër ditore (QD) të kujdesit social. Në rreth 15% të tyre ka një qendër ditore për grupin PAK, në rreth 5% ka një qendër ditore për të moshuarit dhe, në rreth 2% të bashkive qendrat ditore janë për komunitetin rom dhe egjiptian ose për fëmijë jetim.

Në rreth 21% të bashkive janë të ngritura qendra multifunksionale (QMF) të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit social për disa grupe në nevojë. Në rreth 8% të bashkive nuk ka të dhëna.

Gjithashtu, në bashkitë të cilat kanë qendra ditore të kujdesit social ose qendra multifunksionale për grupet në nevojë, numri mesatar i personave që përfitojnë shërbim është 154; numri më i lartë është 1,019 ndërsa numri më i vogël është 8.



Grafiku 24:

Grupet në nevojë për të cilat është themeluar një qendër ditore e kujdesit social në bashki




Problematika dhe sfida

- **Kapacitetet e ulëta financiare** dhe njerëzore për ngritjen e sektorit të vlerësimit të nevojave dhe referimit;
- **Kapacitete të ulëta financiare** për ngritjen e një baze të dhënash për grupet në nevojë mbi bazën e të cilave të hartohen plane vendore veprimi;
- **Kapacitetet të ulëta financiare** për të ngritur qendra ditore të kujdesit social për grupet në nevojë;
- **Bashkëpunim dhe koordinim me institucione** qendrore dhe rajonale në trajtimin e grupeve në nevojë;
- **Bashkëpunimi dhe koordinimi** me OSHC-të vendore në këtë fushë.

Objektivi specifik: mbështetja për programet aktive të punës

Në kuadër të mbrojtjes sociale nëpërmjet programeve aktive të punës, vetëm rreth 10% e bashkive bashkëpunojnë me drejtoritë arsimore rajonale për përmirësimin ose zgjerimin e mundësive për arsim profesional në territorin e tyre, sipas nevojave të tregut të punës. Rreth 79% nuk kanë bashkëpunim në këtë drejtim, dhe në rreth 11% nuk ka të dhëna.



Numri mesatar i të papunëve që marrin ndihmë ekonomike të cilët, njëkohësisht, janë mbështetur financiarisht nga bashkitë për arsim profesional në bashkëpunim me zyrën rajonale të punësimit është 38. Rreth 78% e bashkive të vendit nuk ofrojnë mbështetje financiare në këtë drejtim.

Në të njëjtën mënyrë, numri mesatar i personave nga grupi PAK të cilët janë mbështetur financiarisht nga bashkitë për arsim profesional në bashkëpunim me zyrën rajonale të punësimit dhe shoqatën për PAK është 7. Rreth 80% e bashkive të vendit nuk ofrojnë mbështetje financiare në këtë drejtim.

Numri i të rinjve që përfundojnë arsimin universitar dhe profesional, të cilët, njëkohësisht, janë mbështetur financiarisht nga bashkitë për fillimin e një biznesi privat në fushën e tyre profesionale është 3. Rreth 81% e bashkive të vendit nuk ofrojnë mbështetje financiare në këtë drejtim.

Një grup i veçantë i të papunëve të një shoqërie janë të rinjtë në moshë pune që, përveçse nuk punojnë, as nuk janë duke ndjekur arsim universitar apo profesional; ku grup njihet në shoqëritë e vendeve të BE-së si NEET.


Në Shqipëri, niveli i ndërgjegjësimit të bashkive mbi këtë grup është ende shumë i ulët; vetëm rreth 3% e tyre njohin këtë grup ose kanë një bazë të dhënash për të.



Grafiku 26:

Niveli i ndërgjegjësimit i bashkisë mbi NEET-të në territorin e saj

Për këtë arsye mungon dhe bashkëpunimi me drejtoritë arsimore rajonale për riintegrimin socio-ekonomik të këtij grupi. Në vetëm një bashki të vendit janë mbështetur financiarisht 53 të rinj për riintegrim në sistemin arsimor universitar ose profesional, në bashkëpunim me drejtorinë arsimore rajonale dhe zyrë rajonale të punësimit.



Grafiku 27:

Bashkëpunim me DAR për riintegrimin socio-ekonomik të NEET-it




Problematika dhe sfida

- **Kapacitete financiare të ulëta** për të mbështetur financiarisht të papunët me ndihmë ekonomike dhe personat PAK për arsim profesional;
- **Kapacitete njerëzore të ulëta** për zbatimin e bazës ligjore në këtë fushë;
- **Njohja dhe identifikimi i grupit** NEET në territorin e bashkisë.

Objektivi specifik: përfshirja sociale në nivel vendor

Zhvillimi strategjik i fushës së përfshirjes sociale të grupeve të prekura nga përjashtimi social është i përcaktuar në Dokumentin Politik të Përfshirjes Sociale 2016-2020; qasja bazë për zhvillimin e kësaj fushe është ngritja e një sistemi të matjes së përfshirjes sociale në vend nëpërmjet treguesve statistikorë kombëtare dhe të BE-së si dhe vlerësimit dhe monitorimit të saj. Për këtë nevojitet bashkëpunim të qeverisë qendrore dhe vendore, ashtu si dhe për mbrojtjen sociale. Përgjegjësia që i ngarkohet qeverisë vendore përputhet me funksionet e drejtpërdrejta të saj në fushën e shërbimeve sociale në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.


Rreth 10% e bashkive të vendit kanë një plan vendor veprimi për përfshirjen sociale, të hartuar, në hartim e sipër ose në pritje për miratim, i cili mbështetet nga DPPS. Pjesa më e madhe, rreth 79% e bashkive nuk kanë ende një plan veprimi, ndërsa në rreth 11% të tyre nuk ka të dhëna.



Grafiku 28:

Plan vendor veprimi për përfshirjen sociale

Gjithashtu, baza e të dhënave statistikore me treguesit e BE-së për përfshirjen sociale është e ngritur në rreth 10% të bashkive të vendit, ndërsa mungon në pjesën më të madhe të tyre, ku njëkohësisht nuk është hartuar një plan veprimi në këtë fushë.



Grafiku 29:

Bazë të dhënash statistikore me treguesit e BE-së për përfshirjen sociale e ngritur



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete njerëzore të ulëta** për matjen, vlerësimin dhe monitorimin e treguesve të BE-së mbi përfshirjen sociale;
- **Kapacitete financiare të ulëta** për pjesëmarrje në trajnime nga ministria e linjës;
- **Kapacitete njerëzore të ulëta** për hartimin e një plani vendor veprimi për përfshirjen sociale.

PERFUNDIME MBI POLITIKEN SOCIALE DHE PUNESIMIN

Në drejtim të mbrojtjes sociale në nivel vendor, deri në vitin 2017, sektori për vlerësimin e nevojave dhe referimin për shërbime të kujdesit social është ngritur në rreth 26% të bashkive të vendit; në rreth 69% të tyre nuk është ngritur ende, pra nuk kryhet ende një vlerësim i nevojave të grupeve shoqërore për mbrojtje sociale.

Në rreth 47% të bashkive nuk ka asnjë nëpunës të shtuar për sektorin e mbrojtjes sociale, dhe në rreth 43% të bashkive nuk ka asnjë nëpunës të shtuar për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës kombëtare të ndihmës ekonomike. Numri mesatar i nëpunësve të trajnuar mbi strategjinë kombëtare për mbrojtjen sociale dhe përgjegjësinë që ajo i ngarkon bashkive është 6, ndërsa rreth 14% të tyre nuk kanë asnjë nëpunës të trajnuar. Në rreth 84% të bashkive nuk është hartuar asnjë raport i performancës së shërbimeve të kujdesit social për PAK.

Në rreth 48% të bashkive të vendit nuk ka një qendër ditore të kujdesit social; në rreth 15% të tyre ka një qendër ditore për grupin PAK, ndërsa në rreth 21% të bashkive janë të ngritura qendra multifunksionale të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit social për disa grupe në nevojë. Numri mesatar i personave të grupeve në nevojë që përfitojnë shërbim në qendrat e kujdesit social, ditore apo multifunksionale, është 154.

Në drejtim të mbështetjes për programet aktive të punës, në vitin 2017, rreth 10% e bashkive të vendit kanë bashkëpunuar me drejtoritë arsimore rajonale për përmirësimin ose zgjerimin e mundësive për arsim profesional në territorin e tyre, sipas nevojave të tregut të punës. Megjithatë, rreth 78% e bashkive nuk ofrojnë mbështetje financiare për arsimimin profesional të të papunëve që marrin ndihmë ekonomike, në bashkëpunim me zyrën rajonale të punësimit; në të njëjtën mënyrë, rreth 80% e tyre nuk ofrojnë mbështetje financiare për personat nga grupi PAK.

Rreth 81% e bashkive nuk ofrojnë mbështetje financiare për të rinjtë që përfundojnë arsimin universitar dhe profesional dhe duan të fillojnë një biznesi privat në fushën e tyre profesionale.

Në Shqipëri, niveli i ndërgjegjësimit të bashkive mbi të rinjtë në moshë pune që, përveçse nuk punojnë, as nuk janë duke ndjekur arsim universitar apo profesional është ende shumë i ulët; vetëm 1 bashki njuh këtë grup ose ka një bazë të dhënash për të.


Në drejtim të përfshirjes sociale në nivel vendor, deri në vitin 2017, rreth 10% e bashkive të vendit kanë një plan vendor veprimi për përfshirjen sociale Gjithashtu, baza e të dhënave statistikore me treguesit e BE-së për përfshirjen sociale është e ngritur në rreth 10% të bashkive të vendit; nga ana tjetër, rreth 49% e bashkive nuk janë trajnuar nga ministria e linjës për metodologjinë e matjes dhe vlerësimit e monitorimit të treguesve kombëtarë dhe të BE-së për përfshirjen sociale.

7. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore


Aftësia e qeverisë vendore për mbrojtjen e të drejtave themelore të grupeve shoqërore në nevojë vlerësohet në bazë të përmbushjes së detyrimeve të saj që rrjedhin nga ligji përkatës, pra nëpërmjet shkallës së zbatimit të tij. Objektivat specifik të kësaj fushe janë ngritur mbi këtë bazë për grupet kryesore shoqërore në nevojë.

Objektivi specifik: forcimi i sistemit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Sipas ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, çdo bashki krijon një njësi të mbrojtjes së fëmijës pranë strukturës së saj përgjegjëse për shërbimet shoqërore. Në nivel kombëtar rreth 61% e bashkive kanë krijuar këtë strukturë, ndërsa rreth 34% ende jo. Në rreth 5% të bashkive nuk ka të dhëna.



Rreth 49% e bashkive kanë krijuar gjithashtu një sistem monitorimi të rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë; ky sistem, sipas ligjit, duhet të mundësojë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Rreth 44% e bashkive nuk kanë ende një sistem të tillë, ndërsa në rreth 7% të tyre nuk ka të dhëna.



Numri mesatar i punonjësve për mbrojtjen e fëmijës në bashkitë e vendit është 1; numri më i lartë arrin në 8, por në rreth 45% të bashkive nuk kanë asnjë punonjës. Ligji përcakton se një bashki duhet të ketë minimalisht 1 punonjës për mbrojtjen e fëmijës të posaçëm për çdo njësi administrative të saj që ka më shumë se 3,000 fëmijë. Mbi këtë bazë, treguesi ka nevojë të rivlerësohet me informacion shtesë mbi plotësimin e këtij standardi nga bashkitë e vendit.

Vihen re bashki të cilat, sipas të dhënave, kanë krijuar njësinë për mbrojtjen e fëmijës brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, nga ana tjetër, nuk kanë një sistem për monitorimin e rasteve ose nuk kanë punonjës socialë të posaçëm për mbrojtjen e fëmijës. Në këto bashki krijimi i njësisë për mbrojtjen e fëmijës mund të jetë ende jo i plotë, pra dhe treguesi i mësipërm të jetë i mbivlerësuar. Gjithashtu, një sistem monitorimi që mundëson parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje duhet të përkohet me një numër më të lartë mesatar punonjësish socialë për mbrojtjen e fëmijës; në të kundërt, numri i ulët mesatar i tyre tregon për mundësinë që sistemet e monitorimit të bashkive në këtë fushë të jenë, gjithashtu, ende jo të plotë.

Gjatë vitit 2017 janë identifikuar mesatarisht rreth 19 raste të shkeljeve të të drejtave të fëmijës në bashkitë e vendit; rreth 17 prej tyre janë identifikuar nëpërmjet punonjësve për mbrojtjen e fëmijës. Numri më i madh i rasteve të identifikuara arrin në 310. Në 39% të bashkive të vendit nuk është identifikuar asnjë rast i shkeljes së të drejtave të fëmijës – 62% e këtyre bashkive nuk e kanë të krijuar njësinë për mbrojtjen e fëmijës, ndërsa pjesa tjetër janë bashki ku kjo njësi është krijuar (si dhe bashki ku nuk ka të dhëna). Numri mesatar i urdhrave të mbrojtjes së fëmijës të lëshuara nga bashkitë gjatë vitit të kaluar është rreth 17.

Mesatarisht në bashkitë e vendit gjatë vitit të kaluar është ofruar vetëm 1 shërbim për mbrojtjen e fëmijës. Numri më i madh i tyre ka qenë 12, por në 69% të bashkive nuk është ofruar asnjë lloj shërbimi për mbrojtjen e fëmijës.

Gjatë vitit 2017 bashkitë e vendit kanë shpërndarë për mbrojtjen e fëmijës mesatarisht rreth 1% të buxhetit vendor për shërbime shoqërore. Megjithatë, rreth 82% e tyre nuk kanë shpërndarë buxhet të posaçëm për përmbushjen e këtij funksioni.

Mesatarisht gjatë vitit 2017 bashkitë e vendit kanë organizuar rreth 5 aktivitete për promovimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete financiare** të ulëta për shtimin e burimeve njerëzore në sektor;
- **Mungesën e informacionit** për aktivitete në kuadër të kësaj çështjeje;
- **Mungesë e një baze të dhënash** në sektor;
- **Trajnimi i njësisë për mbrojtjen** e fëmijës për njohuri më gjithëpërfshirëse;
- **Monitorimi dhe vlerësimi** i rasteve të dhunës ndaj fëmijës;
- **Kapacitete financiare** dhe njerëzore të ulëta për shtimin e shërbimeve për fëmijë: shërbime ligjore, psikologjike, arsimore, mbështetje financiare dhe punësimi i

familjarëve;


- **Bashkëpunim i ulët me institucionet** qendrore dhe rajonale në këtë fushë;
- **Kapacitete financiare** dhe njerëzore të ulëta për ngritjen dhe funksionimin e një qendre për fëmijët e dhunuar: vështirësi logjistike, trajnimi i stafit, njohja e legjislacionit dhe kompetencat e ushtruara;
- **Trajtimi në vazhdimësi** i rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijës: luftimi i rasteve të rikthimit të fëmijës në rrugë;
- **Rritja e numrit të punonjësve** për mbrojtjen e fëmijës (PMF);
- **Vonesat në procesin** e marrjes së formës së prerë të disa urdhrave të mbrojtjes.

Objektivi specifik: zbatimi efektiv i ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Ligji 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është plotësisht i përafuar me katër direktiva pjesë e legjislacionit të BE-së në këtë fushë. Mbi këtë bazë ngrihet si objektivi specifik për integrimin në BE zbatimi efektiv i tij nga qeveria vendore.


Numri mesatar i nëpunësve të administratës vendore të trajnuar për ligjin e ri për mbrojtjen nga diskriminimi është 2. Rreth 31% e bashkive nuk kanë asnjë nëpunës të trajnuar në këtë drejtim.

Në 25% të bashkive të vendit është krijuar një sistem për monitorimin e rasteve të diskriminimit të ndodhura në territorin e bashkisë, ndërsa në 69% të tyre ende nuk ka një sistem të tillë. Rreth 6% e bashkive nuk kanë të dhëna.



Rreth 98% e bashkive të vendit nuk kanë organizuar fushata ndërgjegjësimi për mbrojtjen nga diskriminimi të personave të grupit LGBTI.

Pjesa më e madhe e bashkive të vendit, rreth 54%, nuk kanë bashkëpunim me komisionerin për mbrojtjen nga diskriminimi; rreth 13% e tyre kanë lidhur një marrëveshje bashkëpunimi, gjithsesi nuk ndërmerren aktivitete të përbashkëta në këtë fushë, nuk ofrohen shërbime të përbashkëta, dhe as nuk ka një raportim të rregullt e të ndërsjelltë mes dy institucioneve; përjashtim janë 1 ose 2 bashki të cilat përbëjnë 2 deri 3% të bashkive të vendit gjithsej; një pjesë prej 8% bashkëpunojnë në një formë që nuk është asnjë prej këtyre të përmendura. Në rreth 18% të bashkive nuk ka të dhëna.






Problematika dhe sfida

- **Kapacitete financiare të ulëta** për shtimin e burimeve njerëzore në sektor;
- **Përmirësimi i komunikimit** dhe informimit të komunitetit: ndryshimi i mentalitetit të shoqërisë ndaj grupit të personave LGBTI;
- **Trajnime të vazhdueshme** për menaxhimin e rasteve të diskriminimit;
- **Mungesë kapacitetesh njerëzore** për ngritjen e një sistemi monitorimi për rastet e diskriminimit.

Objektivi specifik: zbatimi efektiv i ligjit 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”


Në rreth 28% të bashkive të vendit është krijuar një sistem për monitorimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të pakicave kombëtare në territorin e bashkisë; nga ana tjetër, pakicat kombëtare që janë objekt monitorimi në këto bashki janë kryesisht pakicat rome dhe egjiptiane.



Grafiku 34:

Sistem për monitorimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të pakicave kombëtare

Në rreth 3% të bashkive të vendit bashkia informon në gjuhën e pakicës kombëtare në territorin e saj; kjo përqindje përbëhet nga dy bashki, të cilat kanë pakica kombëtare maqedonase në territorin e tyre. Në bashki të tjera të cilat kanë pakica kombëtare nuk mundësohet informimi në gjuhën e pakicave ose këto bashki nuk kanë të dhëna në këtë drejtim.



Grafiku 35:

Informimi nga bashkia në gjuhën e pakicës kombëtare në territorin e saj

Ligji 96/2017 njih të drejtën e pakicave kombëtare për përdorimin e gjuhës së tyre në marrëdhënie me institucionin në rast se ato janë mbi 20% e numrit të përgjithshëm të popullsisë së bashkisë dhe kur ka një kërkesë të mjaftueshme prej tyre. Mbi këtë bazë, treguesi ka nevojë të rivlerësohet me informacion shtesë mbi plotësimin e këtyre dy kushteve nga bashkitë e vendit.




Problematika dhe sfida

- **Kapacitete financiare të ulëta** për ofrimin e shërbimeve në lidhje me pakicat kombëtare: mungesë mjetesh pune dhe shërbimesh (kompjuter, printer, internet);
- **Mungesë kapacitetesh njerëzore** për ngritjen e një sistemi monitorimi për rastet e diskriminimit;
- **Rritjen e numrit të pjesëmarrësve** në këto aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi të komunitetit;
- **Familjet që i përkasin pakicave kombëtare** janë shpeshherë familje që zhvendosen duke vështirësuar punën për ofrimin e shërbimeve ndaj tyre.

Objektivi specifik: zbatimi efektiv i ligjit 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”

Në nivel kombëtar vetëm rreth 16% e bashkive kanë krijuar njësinë për vlerësimin e nevojave dhe referimin në bashki, e parashikuar në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020; rreth 75% e bashkive nuk e kanë krijuar ende, ndërsa në rreth 9% të tyre nuk ka të dhëna. Numri mesatar i punonjësve socialë në bashki për shërbimin ndaj personave me aftësi të kufizuara është rreth 5, ndërsa në rreth 6% të bashkive të vendit ky grup në nevojë nuk mbulohet nga asnjë punonjës social.



Grafiku 36:


Krijimi i njësisë për vlerësimin e nevojave dhe referimin në bashki

Bashkitë kanë marrë pjesë në mesatarisht 2 trajnime nga autoritetet qendrore për standardet e aksesueshmërisë të personave me aftësi të kufizuara, ku numri më i madh është 8 trajnime, ndërsa rreth 29% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim me këtë tematikë. Gjithashtu, 1 është numri mesatar i trajnimeve nga autoritetet qendrore për vlerësimin e nevojave për dhe referimin në të cilat bashkia ka marrë pjesë; numri më i madh është 3, por rreth 63% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim me këtë tematikë.

Nga PKVPAK parashikohet gjithashtu hartimi nga bashkia i planeve vendore të veprimit për personat me aftësi të kufizuara, në mbështetje të planit kombëtar. Rreth 23% e bashkive të vendit kanë hartuar një plan vendor veprimi në këtë fushë dhe 2% e tyre janë në hartim e sipër të tij. Pjesa më e madhe e bashkive, rreth 66%, nuk kanë ende këtë plan. Në rreth 9% e bashkive të vendit nuk ka të dhëna.




Bashkitë e vendit kryesisht raportojnë rregullisht pranë autoriteteve qendrore për të dhëna mbi personat me aftësi të kufizuara në territorin e tyre, çdo muaj, çdo 2 muaj dhe çdo tre muaj. Rreth 20% e bashkive nuk raportojnë të dhëna të kësaj fushe, ndërsa në rreth 15% e tyre nuk ka të dhëna.



Në rreth 11% e bashkive të vendit infrastruktura për personat me aftësi të kufizuara është e pranishme vetëm në shkollat e qytetit – njësisë administrative qendër të tyre. Ky grup është pjesë e rreth 52% të bashkive të vendit ku kjo infrastrukturë është e pranishme vetëm në një pjesë të shkollave në territorin e tyre. Në rreth 21% të bashkive infrastruktura mungon në të gjitha shkollat dhe në asnjë bashki nuk është duke ndërmarrë investime për pajisjen e tyre. Në rreth 26% e bashkive nuk ka të dhëna.

■ Vetëm në qytet ■ Një pjesë ■ Asnjë ■ Nuk ka të dhëna



Grafiku 39:

Shkolla në bashki të pajisura me infrastrukturë që siguron akses për PAK



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete financiare të ulëta** për përshtatjen e infrastrukturës publike për PAK, mbivendosje shërbimesh, mungesa e akteve nënligjore, mos përfshirja e pagesës së transportit;
- **Trajnim i administratës vendore** mbi raportimin tremujor të bashkisë në ministrinë e linjës për çështjet e PAK;
- **Kapacitete financiare të ulëta** për pjesëmarrjen në trajnime;
- **Kapacitete financiare të ulëta** për të shtuar punonjës në sektor.


Objektivi specifik: përmirësimi i koordinimit të punës ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020

Të drejtat e romëve dhe egjiptianëve janë prioritet i kësaj fushe sipas Planit Kombëtar të Integrit Evropian. Bashkitë janë një nga aktorët kryesorë të hartimit dhe zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020; në përmbajtjen e tyre, një pjesë e fushave politike, objektivave specifike si dhe e masave të parashikuara në këtë plan janë funksione të qeverisë vendore. Një pjesë e tyre janë funksione qendrore ose të deleguara për të cilat ministrinë e linjës bashkëpunojnë me bashkitë nëpërmjet drejtorive e zyrave rajonale të tyre.

Rreth 78% e bashkive të vendit nuk kanë ende nëpunës të trajnuar për zbatimin e PKVIRE; numri mesatar i nëpunësve të trajnuar në nivel kombëtar është 1. Në lidhje me sistemin elektronik të të dhënave ROMALB, numri mesatar i trajnimeve në të cilat bashkitë kanë marrë pjesë është 1, ndërsa 36% e tyre nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim.

Ky sistem përdoret rregullisht nga rreth 44% e bashkive të vendit, ndërsa nuk është ngritur ende në rreth 11% të tyre, gjithashtu, rreth 30% e bashkive nuk e përdorin atë rregullisht.

■ Po ■ Jo ■ Sistemi nuk është ngritur ■ Nuk ka të dhëna




Grafiku 40:

Përdorimi i rregullt i sistemit elektronik ROMALB

Në tërësi, në lidhje me zbatimin e PKVIRE rreth 41% e bashkive të vendit nuk kanë vendosur ende një bashkëpunim me ministrinë e linjës në formën e konsultimeve për zhvillimin e programeve vendore për zbatimin e masave të planifikuara në Plan. Në rreth 36% e tyre nuk ka të dhëna në këtë drejtim. Në rreth 23% të tyre bashkëpunimi është vendosur, dhe madje, në një pjesë më të vogël prej rreth 13% e bashkive të vendit ky bashkëpunim është i vazhdueshëm.


■ I vazhdueshëm ■ Ka bashkëpunim
■ Nuk ka bashkëpunim ■ Nuk ka të dhëna



Grafiku 41:

Niveli i bashkëpunimit të bashkisë me ministrinë e linjës për zbatimin e PKVIRE


Një plan vendor veprimi në zbatim të planit kombëtar PKVIRE është hartuar në rreth 21% të bashkive të vendit, ndërsa pjesa më e madhe, rreth 69%, nuk kanë hartuar këtë plan. Në rreth 10% të bashkive nuk ka të dhëna.



Grafiku 42:

Hartimi i një plani vendor të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve


Pavarësisht mungesës së një plani vendor veprimi për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në pjesën më të madhe të bashkive të vendit, rreth 38% e tyre kanë vendosur bashkëpunim me drejtoritë arsimore rajonale me qëllim identifikimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë në moshën shkollore; gjithashtu, rreth 25% e tyre kanë vendosur bashkëpunim e zyrat rajonale të punësimit për punësimin e romëve dhe egjiptianëve ose me drejtoritë rajonale arsimore për trajnimin profesional të tyre, me qëllim përgatitjen për në tregun e punës.



Grafiku 43:

Bashkëpunim me DAR mbi identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë në moshën shkollore

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e bashkive të vendit, përkatësisht rreth 52% dhe 64%, nuk kanë ende bashkëpunim me asnjërën prej strukturave rajonale të ministrive të linjës, me qëllim integrimin e dy komuniteteve.



Problematika dhe sfida


- **Kapacitete financiare dhe njerëzore** të ulëta për hartimin e një plani vendor veprimi;
- **Kapacitete financiare të ulëta** për ofrimin e shërbimeve në lidhje me komunitetin rom dhe egjiptian: mungesë mjetesh pune (kompjuter);
- **Mungesë qëndrueshmërie** e projekteve që realizohen në bashkia nëpërmjet OSHC-ve;
- **Kapacitete financiare dhe njerëzore** të ulëta për ofrimin e shërbimeve në përputhje me nevojat;

- **Kapacitete të ulëta njerëzore dhe financiare** për mirëmbajtjen dhe përditësimin e të dhënave në sistemin elektronik;
- **Specializimi dhe trajnimi** i administratës vendore në këtë fushë;
- **Ndryshimi i shpeshtë** i administratës vendore në këtë fushë;
- **Kapacitete financiare të ulëta** për ngritjen e grupeve të terrenit të cilët identifikojnë nevojat e komunitetit rom dhe egjiptian;
- **Familjet që i përkasin komunitetit rom** dhe egjiptian janë shpeshherë familje që zhvendosen duke vështirësuar punën për ofrimin e shërbimeve ndaj tyre.

Objektivi specifik: forcimi i sistemit për sigurimin e barazisë gjinore

Për çështjet e barazisë gjinore është hartuar Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimtimit 2016-2020, prej së cilës rrjedhin treguesit e mëposhtëm, sipas instrumenteve të përcaktuar në dokument.


Në rreth 75% të bashkive të vendit është krijuar një strukturë që përgjigjet për barazinë gjinore, ndërsa në rreth 84% të tyre është vendosur një koordinator vendor për barazinë gjinore, pavarësisht nëse ka gjithashtu një strukturë të posaçme apo jo.



Grafiku 45:

Krijimi i një sektori të barazisë gjinore në bashki


Në rreth 15% të bashkive nuk ka ende një koordinator vendor për këtë fushë, i cili është detyrim i qeverisë vendore përcaktuar në SKBGJPV; në rreth 21% të bashkive nuk ka as një strukturë të posaçme.



Grafiku 46:

Koordinator vendor për barazinë gjinore në bashki

Nga ana tjetër, Mekanizmi Kombëtar i Referimit, i përcaktuar në SKBGJPB është shtrirë tashmë në 47 bashki, të cilat përbëjnë rreth 77% e bashkive të vendit.




Grafiku 47:

Ngritja e Mekanizmit Kombëtar të Referimit në bashki

Megjithatë, numri mesatar i trajnimeve nga ministria e linjës për Mekanizmin Kombëtar të Referimit në të cilat bashkitë kanë marrë pjesë gjatë vitit 2017 është 1, ndërkohë që rreth 76% e tyre nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim. Gjithashtu, në rreth 24% të bashkive të vendit nuk ofrohet ende asnjë shërbim i specializuar për gratë viktime të dhunës në familje; mesatarisht në nivel kombëtar ofrohen 2 shërbime të specializuara, numri më i madh i ofruar është 6 shërbime.


Nga rreth 59% e bashkive të vendit kryhet raportimi në ministrinë e linjës i të dhënave të barazisë gjinore në territorin e tyre, në 30% të bashkive ky raportim kryhet në bazë të rasteve të paraqitura, ndërsa në rreth 29% të tyre kryhet në mënyrë të rregullt, çdo muaj, çdo muaj, çdo dy muaj, çdo tremujor ose gjashtëmujor. Nga rreth 25% e bashkive nuk kryhet asnjë raportim, ndërsa në rreth 18% të tyre nuk ka të dhëna.



Grafiku 48:

Raportim (elektronik) i të dhënave të bashkisë në ministrinë e linjës

Objektiva gjinorë janë përcaktuar në rreth 30% të bashkive të vendit në programin buxhetor afatmesëm, ndërsa në 39% të tyre nuk janë përcaktuar; në rreth 31% e bashkive nuk ka të dhëna.



Rreth 36% e bashkive bashkëpunojnë me shoqërinë civile për raste të barazisë gjinore në territorin e tyre kryesisht në formën e organizimit të aktiviteteve të përbashkëta; vetëm në rreth 5% të bashkive ky bashkëpunim bazohet mbi një marrëveshje. Në rreth 3% të bashkive nuk ka bashkëpunim me shoqërinë civile të asnjë forme, ndërsa në rreth 11% e tyre nuk ka të dhëna.



Nga ana tjetër, në rreth 44% të bashkive të vendit nuk ka organizata vendore të shoqërisë civile me të cilat të mund të vendoset një marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e barazisë gjinore.

Numri mesatar i çerdheve dhe kopshteve për fëmijë të ndërtuara nga bashkia në njësitë administrative të tyre gjatë dy viteve të fundit është 1; sipas SKBGJPV nëpërmjet çerdheve dhe kopshteve në zonat rurale të territorit të tyre bashkitë mund të mbështesin gratë në integrimin e tyre në tregun e punës, pra hyrjen në forcën punëtore të vendit. Gjithsesi, rreth 73% e bashkive nuk kanë ndërtuar asnjë kopshte ose çerdhe. Në nivel kombëtar janë organizuar mesatarisht rreth 3 aktivitete nga bashkitë për promovimin e barazisë gjinore; numri më i madh i tyre arrin në 22, por, rreth 42% e bashkive nuk kanë organizuar asnjë aktivitetet ndërgjegjësimi dhe edukimi në këtë fushë.

Gjatë vitit 2017, rreth 65% e 40 bashkive të vendit nuk kanë shpërndarë buxhet për gratë, viktime të dhunës në familje, si për shembull për strehimi social, shërbimet e kujdesit social apo ndihma ekonomike. Megjithatë, për këtë tregues rezultati nuk mund të përgjithësohet në nivel kombëtar për shkak të numri të vogël të përgjigjeve.



Problematika dhe sfida

- Kapacitete financiare të ulëta për ofrimin e shërbimeve në këtë fushë;
- Kapacitete financiare të ulëta për sigurimin e strehimit social ose mungesë e një qendre rezidenciale për viktimat e dhunës;
- Mungesa e mjediseve të posaçme për trajtimin e rasteve në këtë fushë;
- Planifikimi dhe trajtimi i rasteve emergjente;
- Koordinimi i punës me institucionet rajonale që kanë përgjegjësi të përbashkët në këtë fushë;
- Kapacitete financiare të ulëta për mjete pune dhe shërbime: internet;
- Kapacitete financiare të ulëta për të mbuluar rastet e mundshme në njësitë administrative të bashkisë: largësi dhe infrastrukturë e dobët;
- Mungesa e OSHC-ve lokale që veprojnë në këtë fushë me të cilat bashkitë të mund të bashkëpunojë;
- Kapacitete njerëzore të ulëta për mbledhje dhe raportim të dhënash në këtë fushë.

PERFUNDIME MBI GJYQESORIN DHE TE DREJTAT THEMELORE

Në drejtim të forcimi i sistemit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, deri në vitin 2017, rreth 61% e bashkive të vendit kanë krijuar njësinë e mbrojtjes së fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, ndërsa njësia ende mungon në rreth 34% të tyre. Rreth 49% e bashkive kanë krijuar gjithashtu një sistem monitorimi të rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë; në rreth 44% e bashkive sistemi ende mungon.

Gjatë vitit 2017 janë identifikuar mesatarisht rreth 19 raste të shkeljeve të të drejtave të fëmijës në bashkitë e vendit; numri mesatar i urdhrave të mbrojtjes së fëmijës të lëshuara është rreth 17. Në 39% të bashkive nuk është identifikuar asnjë rast i shkeljes së të drejtave të fëmijës – 62% e këtyre bashkive nuk e kanë të krijuar njësinë për mbrojtjen e fëmijës. Rreth 82% e bashkive të vendit nuk kanë shpërndarë buxhet të posaçëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në territorin e tyre.

Në drejtim të mbrojtjes nga diskriminimi, deri në vitin 2017, në 25% të bashkive të vendit është krijuar një sistem për monitorimin e rasteve të diskriminimit të ndodhura në territorin e bashkisë, ndërsa në 69% të tyre ende nuk ka një sistem të tillë. Pjesa më e madhe e bashkive të vendit, rreth 54%, nuk kanë bashkëpunim me komisionerin për mbrojtjen nga diskriminimi; rreth 13% e tyre kanë lidhur një marrëveshje bashkëpunimi, gjithsesi nuk ndërmerren aktivitete të përbashkëta në këtë fushë, nuk ofrohen shërbime të përbashkëta, dhe as nuk ka një raportim të rregullt e të ndërsjelltë mes dy institucioneve.

Në drejtim të mbrojtjes së pakicave kombëtare, deri në vitin 2017, në rreth 28% të bashkive të vendit është krijuar një sistem për monitorimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të pakicave kombëtare në territorin e bashkisë; pakicat kombëtare që janë objekt monitorimi në këto bashki janë kryesisht pakicat rome dhe egjiptiane.

Në drejtim të përfshirjes dhe aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara, deri në vitin 2017, vetëm rreth 16% e bashkive kanë krijuar njësinë për vlerësimin e nevojave dhe referimin në bashki; rreth 63% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim për vlerësimin e nevojave dhe referimin. Numri mesatar i punonjësve socialë në bashki për shërbimin ndaj personave me aftësi të kufizuara është rreth 5, ndërsa në rreth 6% të bashkive të vendit ky grup në nevojë nuk mbulohet nga asnjë punonjës social. Rreth 23% e bashkive të vendit kanë hartuar një plan vendor veprimi për personat e grupit PAK.

Në rreth 52% të bashkive të vendit infrastruktura PAK është e pranishme vetëm në një pjesë të shkollave në territorin e tyre. Në rreth 21% të bashkive infrastruktura mungon në të gjitha shkollat dhe asnjë bashki nuk është duke ndërmarrë investime për pajisen e tyre.

Në drejtim të integritit të romëve dhe egjiptianëve, deri në vitin 2017, rreth 78% e bashkive të vendit nuk kanë ende nëpunës të trajnuar për zbatimin e planit kombëtar të veprimit në këtë fushë. Rreth 41% e bashkive të vendit nuk kanë vendosur ende një bashkëpunim me ministritë e linjës në formën e konsultimeve për zhvillimin e programeve vendore për zbatimin e masave të planifikuara në planin kombëtar të veprimit. Në rreth 23% të tyre bashkëpunimi është vendosur, dhe madje, në një pjesë më të vogël prej rreth 13% e bashkive të vendit ky bashkëpunim është i vazhdueshëm. Një plan vendor veprimi në zbatim të atij kombëtar është hartuar në rreth 21% të bashkive të vendit, ndërsa pjesa më e madhe, rreth 69%, nuk kanë hartuar këtë plan.

Sistemi elektronik i të dhënave ROMALB përdoret rregullisht nga rreth 44% e bashkive të vendit, ndërsa nuk është ngritur ende në rreth 11% të tyre, gjithashtu, rreth 30% e bashkive nuk e përdorin atë rregullisht; numri mesatar i trajnimeve për ROMALB në të cilat bashkitë kanë marrë pjesë është 1, ndërsa 36% e tyre nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim.

Rreth 38% e bashkive kanë vendosur bashkëpunim me drejtoritë arsimore rajonale me qëllim identifikimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë në moshën shkollore; gjithashtu, rreth 25% e tyre kanë vendosur bashkëpunim e zyrat rajonale të punësimit për punësimin e romëve dhe egjiptianëve ose me drejtoritë rajonale arsimore për trajnimin profesional të tyre, me qëllim përgatitjen për në tregun e punës. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e bashkive të vendit nuk kanë ende bashkëpunim me asnjërin prej strukturave rajonale të ministrive të linjës, me qëllim integrimin e dy komuniteteve.

Në drejtim të forcimit të sistemit për sigurimin e barazisë gjinore, deri në vitin 2017, në rreth 75% të bashkive të vendit është krijuar një strukturë që përgjigjet për barazinë gjinore, ndërsa në rreth 84% të tyre është vendosur një koordinator vendor për barazinë gjinore, pavarësisht nëse ka gjithashtu një strukturë të posaçme apo jo. Rreth 76% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim nga ministria e linjës për Mekanizmin Kombëtar të Referimit. Gjithashtu, në rreth 24% të bashkive të vendit nuk ofrohet ende asnjë shërbim i specializuar për gratë viktime të dhunës në familje; mesatarisht në nivel kombëtar ofrohen 2 shërbime të specializuara, numri më i madh i ofruar është 6 shërbime.

Nga rreth 59% e bashkive të vendit kryhet raportimi në ministrinë e linjës i të dhënave të barazisë gjinore në territorin e tyre, në 30% të bashkive ky raportim kryhet në bazë të rasteve të paraqitura, ndërsa në rreth 29% të tyre kryhet në mënyrë të rregullt, çdo muaj, çdo muaj, çdo dy muaj, çdo tremujor ose gjashtëmujor. Nga rreth 25% e bashkive nuk kryhet asnjë raportim.

Objektiva gjinorë janë përcaktuar në rreth 30% të bashkive të vendit në programin buxhetor afatmesëm, ndërsa në 70% të tyre nuk janë përcaktuar ose nuk ka të dhëna.

Rreth 36% e bashkive bashkëpunojnë me shoqërinë civile për raste të barazisë gjinore në territorin e tyre kryesisht në formën e organizimit të aktiviteteve të përbashkëta; vetëm në rreth 5% të bashkive ky bashkëpunim bazohet mbi një marrëveshje. Nga ana tjetër, në rreth 44% të bashkive të vendit nuk ka organizata vendore të shoqërisë civile me të cilat të mund të vendoset një marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e barazisë gjinore.

Rreth 42% e bashkive nuk kanë organizuar asnjë aktivitetet ndërgjegjësimi dhe edukimi në këtë fushë.


8. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, në fushën drejtësisë, lirisë dhe sigurisë përcakton luftën kundër krimit të organizuar si një objektiv kryesor.

Objektivi specifik: zhvillimi i luftës kundër krimit të organizuar

Arritja e këtij objektivi është vlerësuar përmes treguesit grupi i punës në bashki për zbatimin e Planit të Veprimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar i ngritur.

Kështu, ky grup është ngritur në 51% të bashkive të vendit, ndërsa 39% të tjerë akoma nuk e kanë ngritur një grup të posaçëm për zbatimin e Planit të Veprimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar.



Grafiku 51:

Grupi i punës për zbatimin e Planit të Veprimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar



Problematika dhe sfida

- **Bashkëpunimin dhe koordinimin me qeverinë qendrore** për të ngritur grupet e punës për zbatimin e Planit të Veprimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar mbetet i kufizuar;
- **Për sa kohë kjo është një strukturë e re e ngritur** në një pjesë të madhe të bashkive të vendit, nevojitet trajnimi i anëtarëve të grupeve të punës.

PERFUNDIME MBI DREJTESINE, LIRINE DHE SIGURINE

Në drejtim të zhvillimit të luftës kundër krimin të organizuar, deri në vitin 2017, rreth 51% e bashkive të vendit kanë ngritur një grup pune për zbatimin e Planit të Veprimit për Luftën kundër Krimin të Organizuar; rreth 39% të bashkive të vendit ende nuk e kanë ngritur këtë grup.

9. Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura

Objektivi specifik: rritja e pjesëmarrjes në klasat përgatitore të arsimit parashkollor - mundësia e pjesëmarrjes dhe përfshirje masive e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian përcakton rritjen e pjesëmarrjes në klasat përgatitore të arsimit parashkollor si dhe mundësinë e pjesëmarrjes dhe përfshirjes masive të fëmijëve në këtë sistem si një prioritet me rëndësi në fushën e arsimit dhe kulturës. Gjithashtu, Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 përcakton veprimtarinë e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor dhe në klasat përgatitore për përmbushjen e objektivit strategjik të saj për nxënie cilësore dhe gjithëpërfshirëse. Në këtë drejtim, ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i bën bashkitë përgjegjëse për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Në nivel kombëtar, numri mesatar i çerdheve në bashki është 2 fëmijë; numri më i madh është 33, ndërsa 19 bashki të vendit nuk kanë asnjë çerdhe, ku rrjedhimisht, nuk arrihet të adresohen nevojat e komunitetit për këtë shërbim. Rreth 42% e fëmijëve të regjistruar në çerdhe në 2017 janë fëmijëve në moshë çerdheje.

Mbulimi me kopshte, në shkallë kombëtare duket më mirë, ku numri mesatar i kopshteve është 24, numri më i madh është 103. Gjatë vitit 2017, për 38 bashki të vendit 79% e fëmijëve të regjistruar në kopshte janë fëmijëve në moshë kopshti. Megjithatë, për këtë tregues rezultati nuk mund të përgjithësohet në nivel kombëtar për shkak të numri të ulët të përgjigjeve.

Bashkitë e vendit kanë ndërmarrë mesatarisht 1 fushatë ndërgjegjësimi ndaj prindërve për përfshirjen e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor; numri më i madh është 5, ndërsa ka dhe bashki të cilat nuk kanë ndërmarrë asnjë fushatë në këtë kuadër, përkatësisht 45%.

Mesatarisht fondi investimit për zgjerimin e kapaciteteve të çerdheve/kopshteve sipas nevojave të vlerësuara nga bashkitë e vendit është 5,456,193 mijë lekë; vlera më e madhe e buxhetit në këtë drejtim është 120,000,000 mijë lekë; ky rezultat mund të jetë i mbivlerësuar për shkak të komunikimit jo të saktë nga bashkitë të të dhënave të treguesit. Gjithsesi, rreth 72% e bashkive nuk kanë ndërmarrë asnjë investim për zgjerimin e kapaciteteve të çerdheve/kopshteve në bashkinë e tyre.




Problematika dhe sfida

- **Mungesa e kapaciteteve financiare** për investime në infrastrukturë si: shtimi e numrit të klasave, ndërtimi e godinave të reja për kopshte dhe çerdhe, rindërtimin e godinave ekzistuese etj.;
- **Kapacitete të ulëta financiare** për ngritjen e një baze të dhënash digjitale për vlerësimin e nevojave për regjistrimin e fëmijëve në kopshte, si pasojë e mungesës së të dhënave për fëmijët e regjistruar në njësitë administrative të bashkive;
- **Përfshirje e ulët e prindërve** në vendimmarrje, si dhe mungesa e fushatave ndërgjegjësuere për regjistrimin e fëmijëve në kopshte.

Objektivi specifik: përfshirja sasiore dhe cilësore e grupeve të marginalizuara në sistemin e arsimit parauniversitar

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, në fushën e arsimit dhe kulturës e përcakton përfshirjen sasiore dhe cilësore të grupeve të marginalizuara në sistemin e arsimit parauniversitar si një prioritet të rëndësishëm. Treguesit për të vlerësuar objektivin rrjedhin drejtpërdrejtë nga ligji 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

Niveli i bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe drejtorive rajonale për edukimin e masave për uljen e shkallës së braktisjes së shkollës vlerësohet i mirë nga 64% e bashkive në shkallë vendi, rreth 16% e vlerësojnë të dobët, ndërsa për 20% të bashkive nuk ka të dhëna. Megjithatë, ligji 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 nuk i ngarkojnë përgjegjësi / rol bashkisë për trajtimin e braktisjes shkollë, as në bashkëpunim me drejtoritë rajonale arsimore.



Asnjë nga bashkitë nuk ka parashikuar buxhet për të siguruar regjistrimin dhe vijimin e shkollës së çdo fëmije në moshën shkollë, përmes OSHC-ve, shoqatave të komunitetit rom dhe egjiptian, PAK dhe drejtorisë rajonale për arsim.

Në vitin 2017, fondi i buxhetit vendor për mbështetjen financiare të fëmijëve në moshën shkollë, familjet e të cilave u përkasin grupeve në nevojë është mesatarisht 285,714 mijë lekë; të cilat jepen në formën e bursave për fëmijët e këtyre familjeve. Megjithatë, ky rezultat mund të jetë i mbivlerësuar për shkak të komunikimit jo të saktë nga bashkitë të të dhënave të treguesit. Gjithsesi, rreth 74% e bashkive nuk kanë ndarë buxhet për mbështetjen financiare të fëmijëve në moshën shkollë, familjet e të cilave u përkasin grupeve në nevojë.




Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare** për trajtimin e grupeve të marginalizuara në territorin e bashkive të tyre;
- **Kapacitete të ulëta financiare** dhe mungesë koordinimi me institucionet qendrore dhe vendore si: qendrat shëndetësore rajonale, drejtoritë arsimore rajonale dhe struktura të tjera arsimore si dhe Gjendjen Civile për të krijuar një bazë të dhënash digjitale nga e cila të gjenerohen statistika për numrin e fëmijëve të grupit të PAK dhe të komunitetit rom e egjiptian;
- **Qartësimi i rolit të bashkisë në trajtimin** e braktisjes shkollore (burime njerëzore dhe burime financiare).

Objektivi specifik: përmirësimi i infrastrukturës shkollore të arsimit parauniversitar

Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 në objektivin e nxënies dhe gjithëpërfshirjes, përcakton veprimtaritë për krijimin e mjediseve miqësore në shkolla si dhe përfundimin e hartës dhe plotësimin e rrjetit me shkolla të rikonstruara ose të reja si përgjegjësi të bashkisë. Gjithashtu, në këtë drejtim, ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar si përgjegjësi të bashkive.

Rreth 39% e bashkive kanë parashikuar infrastrukturë PAK në projektet për rindërtimin/ndërtimin e shkollave në bashkitë e tyre; ndërsa në 38% të bashkive infrastruktura PAK mungon në projektet e parashikuara, ndërsa për rreth 23% të bashkive nuk ka të dhëna.



Grafiku 53:

Infrastruktura PAK
në projektet për
rindërtimin/ndërtimin
e shkollave

Mesatarisht fondi i investimeve të buxhetit vendor për rindërtimin e shkollave në bashkitë e vendit, në 2017, është 36,472,402 mijë lekë; vlera më e madhe është 653,000,000 mijë lekë; megjithatë, ky rezultat mund të jetë i mbivlerësuar për shkak të komunikimit jo të saktë nga bashkitë të të dhënave të treguesit. Gjithsesi, rreth 43% e bashkive, për vitin 2017, nuk kanë pasur buxhet për rindërtimin e shkollave në bashkitë e tyre.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta** financiare rikonstruksion apo ndërtimin e shkollave të reja në territoret e bashkive të tyre;
- **Kapacitete të ulëta** financiare për shtrirjen e infrastrukturës për PAK në të gjitha institucionet arsimore.

Objektivi specifik: ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale - pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza

Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale - pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza është një prioritet i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020, në fushën e arsimit dhe kulturës. Bashkitë, në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, janë përgjegjëse për zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Rreth 86% e bashkive në nivel kombëtar nuk kanë raportuar asnjë rast shkelje dhe ndërtimi të jashtëligjshëm në zona pjesë të trashëgimisë kulturore të bashkisë; 6 bashki kanë raportuar shkelje, prej nga të cilat 4 kanë ndërmarrë masa.

Mesatarisht fondi i buxhetit vendor për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të bashkive për vitin 2017 është 7,035,046 mijë lekë; vlera më e madhe është 170,957,115 mijë lekë. Megjithatë, ky rezultat mund të jetë i mbivlerësuar për shkak të komunikimit jo të saktë nga bashkitë të të dhënave të treguesit. Gjithsesi, rreth 70% e bashkive nuk kanë ndarë buxhet për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të bashkive, për vitin 2017.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare** për mbrojtjen e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve në territorin e bashkive të tyre;
- **Kapacitete të ulëta financiare të banorëve**, të cilët zotërojnë banesa pjesë të trashëgimisë kulturore, për të përballuar kostot e larta për restaurime sipas kritereve ligjore.

Objektivi specifik: mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020, në fushën e arsimit dhe kulturës e përcakton mbështetjen e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve si një prioritet të rëndësishëm. Në këtë drejtim, bashkitë, në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, janë përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Numri mesatar i aktiviteteve kulturore të organizuara nga bashkitë për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtare në vitin 2017 është 10; numri më i madh është 78, ndërsa 6% e bashkive nuk kanë organizuar asnjë aktivitet promovues në këtë drejtim.

Ndërkohë, bashkitë në kalendarin e aktiviteteve të tyre vjetore organizojnë në mënyrë të rregullt mesatarisht 6 aktiviteteve kulturore për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtare është 6; numri më i madh është 28.

Mesatarisht, fondi i buxhetit vendor për aktivitete kulturore të organizuara nga bashkitë në vitin 2017 është 8,368,752 mijë lekë; megjithatë, ky rezultat mund të jetë i mbivlerësuar për shkak të komunikimit jo të saktë nga bashkitë të të dhënave të treguesit. Ndërkohë, rreth 10% e bashkive, për vitin 2017, nuk kanë ndarë buxhet në këtë drejtim.

Shkalla mesatare e pjesëmarrjes në aktivitetet kulturore të organizuara nga 8 bashki të vendit është 9,509 vetë në vit; numri më i madh është 24,500. Megjithatë, për këtë tregues rezultati nuk mund të përgjithësohet në nivel kombëtar për shkak të numri të ulët të përgjigjeve.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare** për mbështetjen e vazhdueshme të artistëve dhe zhvillimin e aktiviteteve promovuese;
- **Rritja e bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës** si dhe artistë/artizanë për të mbajtur gjallë traditat kulturor si këngët folklorike, veshjet e punimet artizanale të bashkive.

PERFUNDIME MBI ARSIMIN DHE KULTUREN

Në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes në klasat përgatitore të arsimit parashkollor - mundësia e pjesëmarrjes dhe përfshirje masive e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor, 19 bashki të vendit nuk kanë asnjë çerdhe, ndërsa numri mesatar i kopshteve në bashkitë e vendit është 24. Rreth 42% e fëmijëve të regjistruar në çerdhe janë fëmijëve në moshë çerdheje; ndërsa 79% e fëmijëve të regjistruar në kopshte janë fëmijëve në moshë kopshti. Rreth 45% e bashkive të vendit ende nuk kanë ndërmarrë asnjë fushatë ndërgjegjësimit ndaj prindërve për përfshirjen e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor, ndërsa 72% e bashkive nuk kanë ndërmarrë asnjë investim për zgjerimin e kapaciteteve të çerdheve/kopshteve në bashkinë e tyre.

Në drejtim të përfshirjes sasiore dhe cilësore të grupeve të marginalizuara në sistemin e arsimit parauniversitar, asnjë nga bashkitë e vendit nuk ka parashikuar buxhet për të siguruar regjistrimin dhe vijimin e shkollës së çdo fëmije në moshën shkollore, përmes OSHC-ve, shoqatave rome dhe egjiptiane, shoqatave të PAK dhe drejtorisë rajonale për arsim; ndërsa, rreth 74% e bashkive nuk kanë ndarë buxhet për mbështetjen financiare të fëmijëve në moshën shkollore, familjet e të cilave u përkasin grupeve në nevojë.

Në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës shkollore të arsimit parauniversitar, rreth 38% e bashkive ende nuk kanë parashikuar infrastrukturë PAK në projektet për rindërtimin/ndërtimin e shkollave në bashkitë e tyre; ndërsa për vitin 2017, rreth 43% e bashkive të vendit nuk kanë ndarë buxhet për rindërtimin e shkollave në territorin e tyre.

Në drejtim të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale - pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza, rreth 86% e bashkive të vendit nuk kanë raportuar asnjë rast shkelje dhe ndërtimi të jashtëligjshëm në zona pjesë të trashëgimisë kulturore të bashkisë dhe në 6 bashki ku ka pasur raportim për shkelje, në 4 janë ndërmarrë masa. Rreth 70% e bashkive, gjatë vitit 2017, nuk ka ndarë buxhet për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në territorin e bashkive të tyre.

Në drejtim të mbështetjes së krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve, gjatë vitin 2017, bashkitë kanë organizuar mesatarisht 10 aktivitete kulturore për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtare; ndërkohë, mesatarisht bashkitë organizojnë 6 aktivitete të rregullta kalendarike për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtare. Për të organizuar aktivitete kulturore, gjatë vitit 2017, mesatarisht bashkitë e vendit kanë ndarë 8,368,752 mijë lekë buxhet.

10. Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimi i klimës

Objektivi specifik: ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të qeverive vendore për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe administrimit të pyjeve

Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të qeverisë vendore për mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe administrimit të pyjeve është prioritet i procesit të integrimit të vendit në BE; ky prioritet është, njëkohësisht, objektivi specifik në Draft Strategjinë Ndërsektoriale të Mjedisit 2015-2020.

Numri mesatar i nëpunësve të administratës vendore të trajnuar për legjislacionin mjedisor dhe përparësitë e fushës së mjedisit në lidhje me integrimin në BE është 2; numri më i madh i të trajnuarve në një bashki është 7; rreth 23% e bashkive nuk janë trajnuar për këtë temë.

Për zbatimin e legjislacionit mjedisor dhe përparësitë e fushës së mjedisit në lidhje me integrimin në BE mesatarisht në shkallë vendi është trajnuar 1 nëpunës i administratës vendore; numri më i madh i të trajnuarve është 6; ndërkohë, një pjesë e konsiderueshme e bashkive nuk kanë përfituar nga ky trajnim, 31%.



Problematika dhe sfida

- **Trajnime të pakta dhe të vazhdueshme** në kohë për tematika të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe administrimit të pyjeve si dhe vështirësia që njohuritë e marra nga stafi i trajnuar të aplikohen në praktikë.

Objektivi specifik: edukimi i brezave të rinj për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes

Edukimi i brezave të rinj për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes është prioritet i procesit të integrimit të vendit në BE dhe, gjithashtu, objektivi specifik në DSNM.

Në 44 bashki të vendit mesatarja e numrit të fushatave të ndërgjegjësimi në shkolla të mesme dhe 9-vjeçare për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes organizuar nga bashkia është 3; numri më i madh është 14, por ka dhe bashki të cilat nuk kanë organizuar asnjë fushatë me këtë fokus, përkatësisht 21% e tyre. Megjithatë, për këtë tregues rezultati nuk mund të përgjithësohet në nivel kombëtar për shkak të numrit të ulët të përgjigjeve.




Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare** për organizimin e takimeve edukuese/ndërgjegjësuere në shkolla;
- **Angazhim i ulët i aktorëve** vendor të shoqërisë civile, shkollave si dhe nxënësve gjatë trajtimit të çështjeve mjedisore.

Objektivi specifik: hartimi i planeve të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në nivel vendor

Hartimi i planeve vendore të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit është prioritet me rëndësi të lartë i procesit të integrimit të vendit në BE. Në këtë drejtim, DSNM përcakton si objektivi specifik miratimin dhe zbatimin e planeve të veprimit të cilësisë së ajrit në nivel lokal.


Pavarësisht kërkesave ligjore, vetëm 18% e bashkive të vendit kanë hartuar një plani veprimi për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe 2% të tjera janë në punim të këtij plani. Pjesa më e madhe e bashkive, 64% nuk kanë një plan të tillë, ndërsa 16% e tyre nuk kanë të dhëna.



Grafiku 54:

Plan vendor i veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit

Vetëm 20% e bashkive të vendit kanë integruar në dokumentet e tyre strategjike veprime për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit; ndërsa, 62% e bashkive të tjera nuk kanë një dokument të tillë strategjik të integruar; rreth 18% e bashkive nuk kanë të dhëna.



Grafiku 55:

Veprime për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në dokumentin strategjik



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare dhe njerëzore** për hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në nivel vendor.


Objektivi specifik: përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve

Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve është përcaktuar si një prioritet i rëndësishëm i procesit të integritetit të vendit në BE. Gjithashtu, strategjia ndërsektoriale e mjedisit 2015-2020 e përcakton përmirësimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve si objektivi specifik, me fokus përbushjen e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, trajtimin e mbetjeve brenda këtyre standardeve dhe rritjen e ndërgjegjes sociale mbi efektet e dëmshme të mbetjeve në mjedis. Kështu, treguesit e përdorur për të vlerësuar këtë objektivi kanë rrjedhur pikërisht nga kjo strategji.

Këto tregues janë plan vendor i MIM i hartuar, mbledhja dhe depozitimi i mbetjeve urbane të bashkisë bëhet në mënyrë të rregullt sipas Planit, mbetjet e riciklueshme të territorit të bashkisë u kalohen shoqërive të riciklimit, numri i vend-depozitimeve të paautorizuara në territorin e bashkisë, numri i vend-depozitimeve të autorizuara në territorin e bashkisë, mbetjet ndahen në burim në 1-2-3 rryma si dhe largësia e qendrës së bashkisë nga lëndilli më i afërt.

Pavarësisht kërkesave ligjore, vetëm 11% e bashkive të vendit kanë hartuar apo planifikuar një plani vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe 11% të tjera janë në punim të këtij plani. Pjesa më e madhe e bashkive, 62% nuk kanë një plan të tillë, ndërsa 15% e tyre nuk kanë të dhëna.

Po Jo Në punim Nuk ka të dhëna




Grafiku 56:

Plan vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve

Mbledhja dhe depozitimi i mbetjeve urbane të bashkisë bëhet në mënyrë të rregullt nga 43% e bashkive të vendit të cilat kanë një plan të integruar për menaxhimin e mbetjeve; 57% e bashkive të tjera e përdorin pjesërisht atë.


Po Jo Pjesërisht Nuk ka të dhëna




Grafiku 57:

Mbledhja dhe depozitimi i mbetjeve urbane të bashkisë bëhet sipas PMIM

Bashkitë e vendit nuk kryejnë mbledhjen si dhe ndarjen e mbetjeve sipas rrymave të riciklueshme, për rrjedhojë veprimtaria nuk është e pranishme.



Nga ana tjetër, nga mbetjet bashkiake furnizohen kompanitë e riciklimit, porse kjo ndodh në mënyrë jo formale dhe jo nëpërmjet strukturave të bashkisë, të cilat, aktualisht, nuk riciklojnë. Sektori joformal i riciklimit, është i pranishëm, gjithsesi shpesh i kufizuar në një numër të vogël njerëzish të cilët mbledhin nga kontejnerët rrymat e riciklueshme të mbetjeve, kryesisht plastikë, qelq dhe metal.



Numri mesatar i vend-depozitimeve të paautorizuara në territorin e bashkive të vendit është 1; numri më i madh i regjistruar është 5, të cilat mund t'i referohen vend-depozitimeve të ish-komunave apo fshatrave; ndërkohë, rreth 82% e bashkive nuk kanë vend-depozitime të paautorizuara në territorin e tyre. Nga ana tjetër, numri mesatar i vend-depozitimeve të autorizuara në territorin e bashkive është 1, ku numri më i madh i regjistruar është 7; ndërsa, 11% e bashkive nuk kanë asnjë vend-depozitim të autorizuar të miratuar në këshill bashkiak.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta të stafit për të kuptuar** dhe zbatuar bazën ekzistuese ligjore të lidhur me mjedisin dhe posaçërisht menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- **Kapacitete të ulëta financiare** për shtrirjen e shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në të gjithë territorin e bashkisë;
- **Kapacitete të ulëta financiare** për ndërtimin e lëndfill-eve rajonal, e për rrjedhojë mbyllja e vend-depozitimeve të miratuara ose jo me vendim të këshillit bashkiak;
- **Në të gjitha rastet mbetet një sfidë** grumbullimi i diferencuar i mbetjeve dhe ndërgjegjësimi i komunitetit në këtë drejtim.

Objektivi specifik: forcimi i zbatimit të vendimeve të task forcës për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare

Për sa i përket politikave për zhurmën në mjedis, një nga prioritetet kryesore në këtë fushë, identifikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, është forcimi i zbatimit të vendimeve të task forcës së ngritur për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare. Në këtë drejtim, strategjia ndërsektoriale e mjedisit 2015 – 2020 ngre si objektivi specifik forcimin e zbatimit të legjislacionit për zhurmat.

Gjithashtu, sektori rregullohet me ligjin 9774/2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i cili ngarkon me bashkitë me përgjegjësitë për hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për zhurmën; drejtimin e procesit të hartëzimit të zhurmës; shpalljen e zonave të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendosjen e kufizimeve të tjera për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit.

Task forcat e ngritura për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike në territorin e një bashkie kanë një numër mesatar prej 14 inspektorësh të policisë bashkiake; numri më i madh i përfaqësuesve në një task forcë është 19; ndërsa, një pjesë e konsiderueshme e bashkive, 54%, nuk kanë një task-forcë. Megjithatë, për këtë tregues rezultati nuk mund të përgjithësohet në nivel kombëtar për shkak të numrit të ulët të përgjigjeve, nga vetëm 41 bashki.

Kapacitetet inspektuese të bashkive mbeten të ulëta; për afërsisht 83% e bashkive të vendit nuk janë trajnuar nga Ministria e Mjedisit.



Problematika dhe sfida


- **Kapacitete të ulëta financiare** për ngritjen e një strukture task forcë, për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare, për zbatimin e vendimeve.

Objektivi specifik: pyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara nëpërmjet riciklimit në destinacion të të ardhurave nga fondi pyjor dhe detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor

Pyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara është prioritet i procesit të integritetit të vendit në BE. Në këtë fushë DSNM synon menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore dhe kullosore, gjithëpërfshirjen e aktorëve vendorë në menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori, vendosjen e skemave për pagesa në ekosistem si dhe forcimin institucional dhe ligjor.

Gjithashtu, sektori rregullohet me ligjin nr. 9385/2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, nga kanë rrjedhur dhe treguesit për të vlerësuar këtë objektiv.

Rreth 46% e bashkive kanë hartuar një plan veprimi për administrimin e fondit pyjor të bashkisë, por një pjesë e konsiderueshme akoma nuk ka hartuar apo planifikuar në buxhet një plan të tillë, ndërsa rreth 16% e bashkive nuk kanë të dhëna.



Ligji për pyjet dhe shërbimin pyjor i ngarkon bashkitë me përgjegjësinë që **raporti midis një nëpunësi të bashkisë me sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor** që ai mbulon të jetë jo më pak se një nëpunës për: a) 750 – 1,000 ha, për pyjet e larta; b) 1,500 – 2,500 ha, për pyjet e ulëta dhe shkurret; c) 4,000 – 6,000 ha, për kullota dhe livadhe.

Numri mesatar i specialistëve të administrimit të fondit pyjor në një bashki është 5; numri më i lartë është 25; përafërsisht 5% e bashkive nuk ka asnjë inspektor; treguesi mund të përfshijë edhe bashki të cilat në territorin e tyre nuk kanë fond pyjorë. Në vijim, treguesi ka nevojë të rivlerësohet me informacion shtesë mbi plotësimin e kushteve të lartpërmendura ligjore nga bashkitë e vendit.



Problematika dhe sfida

- **Kapacitete të ulëta financiare** dhe njerëzore për hartimin i një plani si dhe ngritjen e një baze të dhënash digjitale për administrimin e fondit pyjorë në territorin e bashkive;
- Gjithashtu një komponent të cilin bashkitë evidentojnë është edhe **sigurimi i fondeve financiare** për të mbështetur ngritjen e kapaciteteve si dhe shtimin e fondit pyjor që ato kanë në territorin e tyre.

PERFUNDIME MBI MJEDISIN DHE NDRYSHIMIN E KLIMES

Në drejtim të ndërgjegjësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të qeverive vendore për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe administrimit të pyjeve, rreth 23% të bashkive të vendit nuk janë trajnuar ende mbi legjislacionin mjedisor dhe përparësitë e fushës së mjedisit në lidhje me integrimin në BE, ndërsa rreth 31% nuk janë trajnuar ende për zbatimin e këtij legjislacioni.

Në drejtim të edukimit të brezave të rinj për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes, në 44 bashki janë organizuar mesatarisht 3 fushata të ndërgjegjësimit në shkolla të mesme dhe 9-vjeçare për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes; në rreth 21% të bashkive të vendit ende nuk është organizuar një fushatë e tillë.

Në drejtim të hartimit të planeve të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në nivel vendor, 39 bashki, të cilat përbëjnë 64% të bashkive të vendit, ende nuk kanë hartuar një plan të tillë. Rreth 62% e bashkive të vendit ende nuk kanë integruar në dokumentet e tyre strategjike veprime për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit.

Në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, 62% e bashkive ende nuk kanë hartuar apo planifikuar një plani vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Nga 7 bashki të cilat kanë një plan të menaxhimit të integruar të mbetjeve, vetëm 3 bashki mbledhin dhe depozitojnë mbetje në mënyrë të rregullt sipas tij. Ende asnjë nga bashkitë e vendit nuk kryen mbledhjen si dhe ndarjen e mbetjeve sipas rrymave të riciklueshme, për rrjedhojë veprimtaria nuk është e pranishme. Rreth 82% e bashkive të vendit nuk kanë vend-depozitime të paautorizuara në territorin e tyre. Mesatarisht bashkitë e vendit kanë 1 vend-depozitim të autorizuar në territorin e bashkisë së tyre.

Në drejtim të forcimit të zbatimit të vendimeve të task forcës për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare, 22 bashki nuk kanë ngritur ende një task forcë, ndërsa rreth 83% e bashkive të vendit nuk janë trajnuar nga Ministria e Mjedisit; rrjedhimisht, kapacitetet inspektuese të bashkive mbeten ende të ulëta.

Në drejtim të pyllëzimit të sipërfaqeve të degraduara nëpërmjet riciklimit në destinacion të të ardhurave nga fondi pyjor dhe detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor, rreth 38% e bashkive nuk kanë hartuar ende një plan veprimi për administrimin e fondit pyjor të bashkisë së tyre. Mesatarisht bashkitë kanë 5 specialistë të administrimit të fondit pyjor në strukturën e tyre.

11. Kapitulli 32: Kontrolli Financiar

Menaxhimi financiar dhe sisteme kontrolli transparente dhe efektive janë prioritet të procesit të integritetit të vendit në BE. Fusha e kontrollit financiar në tërësi rregullohet me ligjin 10296/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, për zbatimin e të cilit nevojiten përpjekje të mëtejshme për rritjen e kapaciteteve njerëzore, sipas vlerësimeve të Raportit të Komisionit Evropian mbi Shqipërinë 2016. Në qeverinë vendore, këshilli bashkiak është përgjegjës në këtë fushë.

Objektivi specifik: forcimi i kapaciteteve të qeverisë vendore në menaxhimin financiar si dhe kontrollin

Treguesit për të vlerësuar këtë objektivi rrjedhin nga Programi i Reformave Ekonomike të Shqipërisë 2017-2019.

Realizimi i planit të shpenzimeve vjetore nga bashkitë paraqitet në një nivel të mirë, mesatarisht 83%; ka bashki të cilat kanë arritur ta realizojnë 100% këtë plan, ndërkohë vlera minimale e regjistruar për këtë tregues është 62%. Ndërkohë, 27 bashki realizojnë mesatarisht 81% të planit të të ardhurave vjetore të planifikuara, por për këtë tregues rezultati nuk mund të përgjithësohet në nivel kombëtar për shkak të numrit të ulët të përgjigjeve.

Në 37 bashki të vendit mesatarja e numrit të kontrolleve të brendshme të ndërmarrë nga këshilli bashkiak vitin e fundit është 2, por për këtë tregues rezultati nuk mund të përgjithësohet në nivel kombëtar për shkak të numrit të ulët të përgjigjeve.

Bashkitë raportojnë mesatarisht 33% rënie të nivelit të detyrimeve të konstatuara dhe të papaguara ndaj të tretëve gjatë dy viteve të fundit; 5% e bashkive raportojnë të kenë shlyer 100% të detyrimeve të tyre, por ka dhe bashki të cilat nuk kanë arritur të bëjnë asnjë ndryshim për të përmirësuar këtë tregues, përkatësisht 8% e tyre.



Problematika dhe sfida

- **Realizimi i planit të të ardhurave** dhe mbajtja nën kontroll e shpenzimeve të bashkisë;
- **Fonde të pa mjaftueshme** për të financuar projektet të mëdha strategjike;
- **Kapacitete të ulëta financiare** për shlyerjen e detyrimeve të konstatuara dhe të papaguara ndaj të tretëve;
- **Realizimi i kontrolleve të brendshme** të ndërmarrë nga këshilli bashkiak për shkak të kapaciteteve të ulëta të anëtarëve të këshillit bashkiak, nevoja e trajnimit të tyre mbi këtë proces;
- **Rritja e kapaciteteve të stafit të bashkisë** për përdorimin e regjistrit kombëtar për PAK.

PERFUNDIME MBI KONTROLLIN FINANCIAR

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve të qeverisë vendore në menaxhimin financiar dhe kontrollin, mesatarisht bashkitë e vendit kanë realizuar 83% të planit të shpenzimeve vjetore; ndërsa, 27 bashki kanë realizuar mesatarisht 81% të planit të të ardhurave vjetore të planifikuara.

Në 37 bashki të vendit, këshilli bashkiak, në vitin 2017, ka ndërmarrë mesatarisht 2 kontrolle të brendshme. Vërehet një rënie mesatare me 33% të nivelit të detyrimeve të konstatuara dhe të papaguara të bashkive ndaj të tretëve gjatë dy viteve të fundit.

LISTA E GRAFIKEVE

Grafiku 1. Ngritja e një zyre (unike) me një ndalesë në bashki	19
Grafiku 2. Vendime të bashkisë të publikuara në faqen e internetit të bashkisë	20
Grafiku 3. Buxheti vendor i publikuar në faqen e internetit të bashkisë ose nëfinancatvendore.al	21
Grafiku 4. Format e përfshirjes së komunitetit në procesin e përgatitjes së PBA-së	22
Grafiku 5. Ngritja e një rrjeti të koordinatorëve vendorë anti-korrupsion në bashki	25
Grafiku 6. Vendosja e pikave të kontaktit vendor anti-korrupsion në bashki	26
Grafiku 7. Shkalla e përditësimit të regjistrit elektronik të bashkisë	26
Grafiku 8. Ngritja e mekanizmi monitorimi e vlerësimi të ofrimit të ndihmës ekonomike në bashki	27
Grafiku 9. Niveli i bashkëpunimit të bashkisë me OSHC-të në fushën e të drejtave të njeriut	29
Grafiku 10. Përgatitja e një dokumenti strategjik zhvillimi të bashkisë	31
Grafiku 11. Aktivitete të bashkisë për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	32
Grafiku 12. Shërbimet e bashkisë që mbështesin zhvillimin e ndërmarrjeve vogla e të mesme	32
Grafiku 13. Zyra për zhvillimin dhe promovimin e turizmit e ngritur dhe funksionale	33
Grafiku 14. Ngritja e Zyrës së Informacionit Bujqësor dhe Zyrës Këshilluese në bashki	35
Grafiku 15. Zonat bujqësore të lidhura me qendrat tregtare me një rrjet të plotë të rrugëve	36
Grafiku 16. Ndryshimi i fondit buxhetit vendor për rrjetin rrugëve për lidhjen e zonave bujqësore	36
Grafiku 17. Plan vendor i hartuar për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit në bashki	37
Grafiku 18. Shpeshësia e kontrolleve veterinarë në pikat e therjes së mishit nga bashkia	40
Grafiku 19. Plan i transportit publik të bashkisë i publikuar në stacionet e autobusëve	45
Grafiku 20. Politika tatimore të bashkisë për nxitjen e formalizimit të ekonomisë në territorin e saj	48
Grafiku 21. Ngritja e një baze të dhënash të debitorëve të bashkisë	49
Grafiku 22. Sektor i Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit i ngritur në bashki	51
Grafiku 23. Bazë të dhënash statistikore mbi shërbimet e kujdesit social të ofruara nga bashkia	52
Grafiku 24. Grupet në nevojë për të cilat është krijuar qendër ditore e kujdesit social në bashki	52
Grafiku 25. Bashkëpunim me DAR për përmirësimin / zgjerimin e mundësive arsim profesional	53
Grafiku 26. Niveli i ndërgjegjësimit i bashkisë mbi NEET-të në territorin e saj	54
Grafiku 27. Bashkëpunim me DAR për riintegrimin socio-ekonomik të NEET-it	54
Grafiku 28. Plan vendor veprimi për përfshirjen sociale	55
Grafiku 29. Bazë të dhënash statistikore me treguesit e BE-së për përfshirjen sociale e ngritur	55
Grafiku 30. Krijimi i njësisë për mbrojtjen e fëmijës në bashki	57
Grafiku 31. Sistem për monitorimin e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje	57
Grafiku 32. Sistem për monitorimin e rasteve të diskriminimit	59
Grafiku 33. Niveli i bashkëpunimit të bashkisë me komisionerin për mbrojtjen nga diskriminimi	59
Grafiku 34. Sistem për monitorimin e rasteve të shkeljes së të drejtave së pakicave kombëtare	60
Grafiku 35. Informimi nga bashkia në gjuhën e pakicës kombëtare në territorin e saj	60
Grafiku 36. Krijimi i njësisë për vlerësimin e nevojave dhe referimin në bashki	61
Grafiku 37. Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Përfshirjen Sociale të PAK	62
Grafiku 38. Raportimi i bashkisë pranë autoriteteve qendrore i të dhënave për PAK	62
Grafiku 39. Shkolla në bashki të pajisura me infrastrukturë që siguron akses për PAK	63
Grafiku 40. Përdorimi i rregullt i sistemit elektronik ROMALB	64
Grafiku 41. Niveli i bashkëpunimit të bashkisë me ministrinë e linjës për zbatimin e PKVIRE	64
Grafiku 42. Hartimi i një plani vendor të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve	65
Grafiku 43. Bashkëpunim me DAR mbi identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë në moshën shkollorë	65
Grafiku 44. Bashkëpunim me ZRP për punësimin ose me DAR mbi trajnimin profesional dhe arsimor të romëve dhe egjiptianëve	66
Grafiku 45. Krijimi i një sektori të barazisë gjinore në bashki	67
Grafiku 46. Koordinator vendor për barazinë gjinore në bashki	67

Grafiku 47. Ngritja e Mekanizmit Kombëtar të Referimit në bashki	68
Grafiku 48. Raportim (elektronik) i të dhënave të bashkisë në ministrinë e linjës	68
Grafiku 49. Përcaktimi i objektivave gjinorë në PBA	69
Grafiku 50. Niveli i bashkëpunimit i bashkisë me shoqërinë civile për diskriminimin gjinor	69
Grafiku 51. Grupi i punës zbatimin e Planit të Veprimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar	73
Grafiku 52. Bashkëpunimi me DAR për masa për uljen e shkallës së braktisjes së shkollës	76
Grafiku 53. Infrastruktura PAK në projektet për rindërtimin/ndërtimin e shkollave	77
Grafiku 54. Plan vendor i veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit	82
Grafiku 55. Veprime për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në dokumentin strategjik	82
Grafiku 56. Plan vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve	83
Grafiku 57. Mbledhja dhe depozitimi i mbetjeve urbane të bashkisë bëhet sipas PMIM	83
Grafiku 58. Mbetjet ndahen në burim në 1-2-3 rryma	84
Grafiku 59. Mbetjet e riciklueshme të territorit të bashkisë u kalohen shoqërive të riciklimit	84
Grafiku 60. Plan veprimi për administrimin e fondit pyjor në territorin e bashkisë	86

